2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 148, datë 11.3.2022

**PËR MIRATIMIN E NOTËS SË
ADERIMIT, PËR T’U BËRË PJESË NË
MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT
(MOU), NDËRMJET QEVERISË SË
DUKATIT TË MADH TË
LUKSEMBURGUT DHE SHTABIT TË
KOMANDËS SUPREME ALEATE PËR
TRANSFORMIMIN, SI DHE SHTABIT
SUPREM TË FUQIVE ALEATE NË
EVROPË, NË LIDHJE ME DHËNIEN E
MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS
PËR EKZEKUTIMIN E
OPERACIONEVE/STËRVITJEVE/
AKTIVITETEVE TË NGJASHME
USHTARAKE TË NATO-s**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e notës së aderimit, për t’u bërë pjesë në memorandumin e mirëkuptimit (MOU), ndërmjet qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënie mbështetjeje së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve/aktiviteteve të ngjashme ushtarake të NATO-s, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



SHTOJCË 1 E
SH/OLA/RLB/139/2020
Datë 21 shtator 2020

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI (MOU)
NDËRMJET QEVERISË SË
DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT
DHE SHTABIT TË KOMANDËS SUPREME
ALEATE PËR TRANSFORMIMIN,
SI DHE SHTABIT SUPREM TË FUQIVE
ALEATE NË EVROPË, NË LIDHJE ME
DHËNIEN E MBËSHTETJES SË SHITËTIT
PRITËS PËR EKZEKUTIMIN E
OPERACIONEVE/STËRVITJEVE/AKTIVIT
ETEVE TË NGJASHME USHTARAKE
TË NATO-s

Hyrje

Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut, e përfaqësuar nga ministri i Mbrojtjes (MM) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE), në vijim të referuar si Pjesëmarrësit,

duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut Verior, të datës 4 prill 1949 dhe veçanërisht nenin 3 të tij;

duke pasur parasysh dispozitat e marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (SOFA NATO), të datës 19 qershor 1951, Protokollin për Statusin e Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar të ngritur në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut (Protokollin e Parisit), të datës 28 gusht 1952, Marrëveshjen ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcat e tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995, Protokollin Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqen në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokollin Shtesë i PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995 dhe duke përfshirë Protokollin Tjetër Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të tyre

(Protokollin Tjetër Shtesë i PfP SOFA), të datës 19 dhjetor 1997;

duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën e NATO-s, dhe kontrollit të ose nëpërmjet territorit të Dukatit të Madh të Luksemburgut gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të Operacioneve Ushtarake të NATO-s;

duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve që parashikohen të ndodhin me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forcave të tjera të udhëhequra nga NATO;

dhe

duke marrë parasysh nevojat e Dukatit të Madh të Luksemburgut, që në vijim referohet si Shteti Pritës dhe nevojat e Komandës Aleate për Transformimin (ACO) dhe Komandës Aleate për Transformimin (ACT), në vijim e referuar si Komanda Strategjike (SC),

pjesëmarrësit kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

SEKSIONI I PARË

Përkufizime

Për qëllimet e këtij MOU-i dhe dokumenteve mbështetëse, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 Forcat – të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO, që përfshijn të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave, siç përkufizohen te NATO SOFA, Protokollin e Parisit dhe PfP-ja ose shteteve të tjera që marrin pjesë nën drejtimin e NATO-s. Termi përfshijn gjithashtu të gjithë anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet dhe municionin, si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, duke përfshirë kontraktuesit që angazhojnë ose mbështesin forcën.

1.2 Operacionet e NATO-s – Veprimet ushtarake duke përfshirë stërvitjet, trajnimin, eksperimentimin operacional dhe aktivitete të tjera ose kryerjen e misionëve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative të realizuara nga forcat; procesi i zhvillimit të luftimit, duke përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo beteje ose fushate.



1.3 Komandant i NATO-s – Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s – Komandat ose njësitë e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Komanda Ushtarake Ndërkombëtare – Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s ose që u është dhënë statusi nga VAC/DPC. Përfshin aktivitetet që mund të jenë detashmente të përkohshme ose njësi/reparte të Komandave.

1.6 Komanda Kombëtare – Komandat e forcave kombëtare në komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.7 Komanda Shumëkombëshe – Komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Shteti Dërgues (SN) – Ato shtete dhe HQ ose elementet e tyre që angazhohen në territorin e SP-së, në mbështetje të Operacioneve Ushtarake të NATO-s.

1.9 Shteti Pritës (SP) – Dukati i Madh i Luksemburgut.

1.10 Komanda ose Komandantët Strategjikë (KK) – Komandanti Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR) dhe Komandanti i Komandës së Aleatëve për Operacionet (ACO) dhe Komanda Aleate Supreme për Transformimin (SACT), Komandanti i Komandës Aleate për Transformimin (ACT).

1.11 Mbështetje e Shtetit Pritës (HNS) – Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet në paqe, emergjencë, krizë dhe konflikt nga një Shtet Pritës forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë transit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës.

1.12 Mbrojtja e Forcës (FP) – Të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjediseve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

1.13 Shpenzimet – Ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e Komandave Ndërkombëtare, forcave kombëtare, shumëkombëshe ose organizatave të NATO-s. Për

qëllimet e këtij MOU-i dhe dokumenteve të saj mbështetëse:

a) **Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s** – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord të jenë përgjegjësi e përbashkët e aleancës;

b) **Shpenzime të Përbashkëta** – Ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e shpenzimeve të përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjen Teknike dhe/ose Masat përkatëse të Përbashkëta të Zbatimit.

c) **Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare** – Ato shpenzime që konsiderohen të jenë përgjegjësi e një SN-je të vetëm.

1.14 Financim i Përbashkët i NATO-s – Fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për Shpenzimet e Zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të aktiviteteve ushtarake të NATO-s, të specifikuara në të.

1.15 Notë Pranimi (NOA) – Një dokument që cakton synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në, sipas dispozitave të këtij MOU-i, për një aktivitet të drejtuar nga NATO.

1.16 Deklaratë Synimi (SOI) – Një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në, sipas dispozitave të këtij MOU-i, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme për dispozitat e HNS-së.

1.17 Masë Teknike (TA) – Një masë pasuese bilaterale për një aktivitet ushtarak të specifikuar të NATO-s. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dispozitat e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-s dhe SN-ve.

1.18 Masë e Përbashkët Zbatimi (JIA) – Një masë bilaterale pasuese që vendos angazhimin ndërmjet palëve, në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuara të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose kushtet e pagesës.

1.19 Komiteti Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët të Shtetit Pritës (JHNSSC) – Një komitet i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i bashkëkryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjitha SN-të, HN-ja dhe Komandanti(ët) e NATO-s takohen për të



koordinuar masat e nevojshme përmirësuese në lidhje me HNS-në, si TA-ja dhe JIA(të), sipas rastit.

1.20 Vendet Operacionale – Vendet që gjenden në territorin e HN-së për qëllimin e mbështetjes operacionale dhe/ose logjistike, për forcën, për operacionet ose stërvitjet e NATO-s. Këto vende janë detashmente të një Komande Strategjike nën komandën e një Komandanti të NATO-s.

1.21 Përveç kur një kuptim specifikohet ndryshe në këtë MOU, zbatohet fjalori i NATO-s për termat dhe përkufizimet (AAP-6).

SEKSIONI I DYTË Qëllimi

2.1 Qëllimi i këtij MOU-i është vendosja e politikës dhe procedurave për përcaktimin e vendeve operacionale dhe ofrimin e HNS-së të forcat e NATO-s, ose të mbështetur nga HN-ja, gjatë aktiviteteve ushtarake të NATO-s.

2.2 Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga autoriteti përkatës i HN-së dhe nga Komandantët e NATO-s, duke parashikuar masat e HNS-së për një sërë operacionesh të NATO-s. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI I TRETË Objekti dhe masa të përgjithshme

3.1 Dispozitat e NATO-s ose PpP SOFA, Protokollit të Parisit dhe Protokollit Tjetër Shtesë dhe çdo marrëveshjeje tjetër përkatëse, që mund të jenë në fuqi ndërmjet Shtabeve Supreme dhe HN-së, zbatohen për të gjitha aktivitetet ushtarake të NATO-s.

3.2 HN-ja njihet vendet operacionale të vendosura në zbatim të këtij MOU-i që të jenë detashmente të Shtabeve Supreme krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmenteve të jenë ndërmarrje të Shtabeve Supreme. Këto vende që duhet të vendosen, identifikohen në dokumentet pasuese. Masat e komandës dhe kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operacionale.

3.3 Ky MOU synon të jetë në pajtim me doktrinën dhe politikën e NATO-s, dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për HNS-në.

Doktrina dhe politika të tjera përkatëse, për të cilat bien dakord bashkërisht Pjesëmarrësit, mund të zbatohen për operacionet e drejtuara nga NATO.

3.4 HN-ja do të ofrojë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë aktualisht, për forcat e angazhuara në aktivitetet ushtarake të NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë.

3.5 Dispozitat e këtij MOU-i zbatohen në paqe, emergjencë, krizë dhe konflikte ose periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të përcaktohet reciprokisht nga HN-ja dhe autoritetet përkatëse të NATO-s.

3.6 Ndërsa SN-të inkurajohen të marrin pjesë në aktivitetet ushtarake të NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e këtij MOU-i, si një dokument ombrellë, sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja, marrëveshjet e veçanta bilaterale me shtetet individuale mund të merren parasysh nga HN-ja rast pas rasti.

3.7 HN-ja dhe SC-të mund të caktojnë përfaqësues për të negociuar dokumentet pasuese që mbështesin dhe përmirësojnë këtë MOU.

3.8 Aktivitetet ushtarake të NATO-s, të mbështetura nga ky MOU, mund të kërkojnë operacione ajrore të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja njihet që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre, në dhe përmes zonave territoriale të HN-së, do të bëhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e aktivitetit ushtarak të NATO-s. HN-ja do të administrojë/kontrollojë të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.

SEKSIONI I KATËRT Dokumentet e referencës

Dokumentet e referencës, që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU, gjenden tek aneksi A.

SEKSIONI I PESTË Përgjegjësitë

Brenda dispozitave të këtij MOU-i:

5.1 Shteti Pritës:



a) Gjatë hartimit të dokumenteve mbështetëse dhe me ndodhjen e ndryshimeve, dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja kryen njoftim në kohën e duhur për Komandantin e NATO-s, në lidhje me disponibilitetin ose ndonjë mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s mbështeten të dokumentet mbështetëse të hartuara për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara në lidhje me strukturat dhe aftësitë kombëtare;

b) Me qëllim që të jepet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes, për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja e siguruar me prokurim përftohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues nga ofertuesi më i ulët i përshtatshëm;

c) HN-ja mban regjistra administrative dhe financiare, të nevojshëm për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohen për NATO-n, siç kërkohej nga qëllimet e auditimit;

d) Standardet e mallrave dhe shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në pajtim me hollësitë e përcaktuara të dokumentet mbështetëse;

e) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë;

f) HN-ja do të ofrojë, para çdo Operacioni të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HN-së;

g) HN-ja do të ftojë SN-në të pranojë dispozitat e këtij MOU-i nëpërmjet një note pranimi ose deklarate synimi;

h) HN-ja (në bashkëpunim me Komandantin e NATO-s) i jep forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/pajisjet ushtarake të HN-së, sipas të njëjtat kushteve që u jepen ushtarakëve të HN-së;

i) HN-ja ofron procedurat për lidhjet mjekësore ndërmjet HN-së dhe SN-së, duke përfshirë POC-in;

j) Gjatë hartimit të dokumenteve mbështetëse, HN-ja do t'i ofrojë Komandantit të NATO-s kopje, në gjuhën angleze, të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie, mjedisore dhe bujqësore që mund të zbatohet për aktivitetin ushtarak të NATO-s, si dhe çdo rregulloreje në lidhje me

ruajtjen, lëvizjen ose disponimin e materialeve të rrezikshme;

k) HN-ja pranon që kopjet e listave të ngarkesave të SN-së për pajisje dhe furnizime, si për përdorim ushtarak dhe personal, në përputhje me SOFA NATO, do të jetë dokumentacion i mjaftueshëm për qëllimet doganore.

5.2 Komandanti i NATO-s:

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që struktura e misionit dhe forcës që përcaktohet për një plan operacional (OPLAN), një urdhër operacional (OPORD) ose një urdhër operacional stërvitor (EXOPORD) nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur;

b) Komandanti i NATO-s i paraqet HN-së njoftim, në kohë, në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave, dhe propozon modifikimin e dokumenteve mbështetëse, sipas rastit;

c) Komandanti i NATO-s përcakton nëse ofrohet financimi i përbashkët dhe cilat kërkesa janë të përshtatshme për financim të përbashkët;

d) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara HNS dhe aprovon çmimet në lidhje me Shpenzimet e Përbashkëta;

e) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në, për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga financimi i përbashkët. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon, në masën e nevojshme, në përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve;

f) Nëse kërkesat e SN-ve bien në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s, për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira;

g) Komandanti i NATO-s identifikon personelin dhe kërkesat e tjera për operimin e vendeve që caktohen në HN;

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose të JHNSSC-ja.

5.3 Shtetet Dërguese:

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në, duke



pranuar dispozitat e këtij MOU-i, me anë të një NOA-ja ose duke nxjerrë një SOI për një aktivitet ushtarak të caktuar të NATO-s;

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-së ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s;

c) Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga burimet ushtarake, përveç kur përdoren, siç është rënë dakord, procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile paguhen drejtpërdrejt nga SN-të;

d) SN-të ofrojnë personel të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet;

e) SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave HNS të HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s, kur ato kryhen, dhe paraqet kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet;

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja;

g) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë që janë identifikuar për vendet operacionale, si dhe çdo rregullore të HN-së për ruajtjen, lëvizjen ose disponimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI I GJASHTË

Dispozita financiare

6.1 Me marrëveshje të ndërsjella dhe/ose konventa ndërkombëtare, aktivitetet e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare, vendet operacionale, anijet, avionët ose automjetet në pronësi dhe/ose të kontraktuara nga NATO, dhe karburanti, vajrat dhe lubrifikantët (POL) të ofruara Forcës janë të përjashtuara nga tatimet, detyrimet, pagesat shtetërore, tarifatat dhe të gjitha pagesat e ngjashme.

6.2 Protokollin e Parisit, Protokollin Tjetër Shtesë dhe e drejta ndërkombëtare zakonore që zbatohen imunitetet dhe privilegjet, në lidhje me Komandat Ushtarake Ndërkombëtare, zbatohen për çdo element të komandave ose detashmente që mund

të angazhohen të HN-ja në zbatim të një aktiviteti ushtarak të NATO-s.

6.3 Pajisjet, furnizimet, produktet, materialet dhe shërbimet e importuara përkohësisht dhe të eksportuara nga territori i HN-së, në lidhje me një aktivitet ushtarak të NATO-s, përjashtohen nga të gjitha detyrimet, taksat dhe tarifatat. Procedurat e tjera doganore do të përcaktohen në përputhje me NATO-n ose Pfp SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin tjetër shtesë, sipas rastit.

6.4 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifatat ose pagesat e ngjashme nuk është i mundur, për blerjet e kryera nga ekonomia vendase e HN-së, detyrimet nuk vendosen në një normë më të lartë sesa ajo që zbatohet për forcat e armatosura të HN-së². Të gjitha shpenzimet duhet të përpunohen me shumën më të vogël që shoqëron kërkesat administrative.

6.5 Transaksionet financiare që përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive në çdo institucion bankar privat ose qeveritar, duhet të kryhen pa marrë asnjë pagesë apo tarifë të asnjë lloji.

6.6 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me Financimin e Përbashkët të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të aktivitetit ushtarak të NATO-s. Të gjitha masat financiare që negociohen paraprakisht duhet të jenë specifike, në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin Financim të Përbashkët nga NATO.

6.7 Dokumentet mbështetëse ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Përbashkëta të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

6.8 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të përballueshme nga Financimi i Përbashkët i NATO-s (nga alokimet e aprovuara të buxhetit), SC-ja përkatëse autorizon Financimin e Përbashkët për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursos HN-në.

²Brenda vendeve të Nato-s dhe Pfp-së, forcat janë të përjashtuara nga tatimi për karburantet.



6.9 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime mund të identifikohen si Shpenzime të Përbashkëta dhe, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshira, mund të ndahen në pajtim me formulën e ndarjes së shpenzimeve të aprovuara në TA ose dokumente të tjera mbështetëse.

6.10 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile, dhe ushtarake të siguruara nga HN-ja nuk vendosen me një normë më të lartë sesa ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së, dhe nuk përfshijnë shpenzime të tepërta administrative ose shpenzime të tjera, por mund të reflektojnë përshtatje për shkak të grafikëve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose konsideratave të ngjashme. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.

6.11 Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnitorët tregtarë për furnizime, shërbime ose mbështetje tjetër.

6.12 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe, si të tilla, mund të operojnë pa siguracion tregtar.

6.13 HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose SN-së, përveç kur i kërkohej specifikisht ta bëjë këtë, paraprakisht, nga një përfaqësues i autorizuar dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Gjithashtu, asnjë fond nuk jepet para se Shtabet Supreme ose SN-të, sipas rastit, të kenë aprovuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.

6.14 Në lidhje me këtë MOU nuk është dhënë financim dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Komandantit të NATO-s ose SN-ve.

Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse.

6.15 Caktimi i vendeve operationale në mbështetje të aktiviteteve ushtarake të NATO-s nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

SEKSIONI I SHTATË

Konsiderata juridike

7.1 Shtabet Supreme realizojnë ose delegojnë veprime juridike që janë thelbësore për përmbushjen e misionëve, duke përfshirë, pa u kufizuar, në ushtrimin e kapacitetit për të lidhur kontrata, angazhuar në procedime gjyqësore ose administrative dhe përftojnë, dhe disponojnë mbi pronën.

7.2 Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në pajtim me NATO-n/PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë.

7.3 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin nga ose janë në lidhje me ekzekutimin e këtij MOU-i trajtohen në pajtim me dispozitat e NATO-s/PfP SOFA.

7.4 Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen nga HN-ja, sipas proceseve që rregullojnë kontratat publike dhe në pajtim me ligjin e HN-së, me rimbursim nga Komanda e NATO-s ose SN-ja, sipas rastit.

SEKSIONI I TETË

Mbrojtja e forcës

8.1 FP-ja e plotë dhe efektive planifikohet për Komandën Statike të NATO-s dhe të gjitha aktivitetet e ngjashme ushtarake, dhe detajohet në OPLANS, EXPIs ose marrëveshjet shtesë, sipas rastit. FP-ja zbatohet në pajtim me politikën dhe procedurat e NATO-s, dhe në një mënyrë që është në pajtim me NATO PfP SOFA. FP-ja nuk kërkohej në asnjë rrethanë të jetë në kundërshtim me NATO PfP SOFA ose ligjet e HN-së.

8.2 Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

8.3 Sipas rastit, çdo SN është përgjegjës për identifikimin dhe paraqitjen e kërkesave dhe kufizimeve të FP-së tek HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.

8.4 Përveç këtyre përgjegjësi të FP-së, të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për FP-në, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin e gjithçkaje që kërkohej dhe paraqitet për HN-në dhe SN FP-në, sipas rastit, për mbrojtjen e Forcës.



SEKSIONI I NËNTË

Siguria dhe deklarimi i informacionit

9.1 Ndërmjet Shteteve të Aleancës, informacioni i klasifikuar, i ruajtur, i trajtuar, i gjeneruar, transmetuar ose shkëmbyer si rezultat i ekzekutimit të këtij MOU-i, trajtohet në përputhje me C-M (2002) 49 “Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut”, të datës 17 qershor 2002, në botimin përkatës të autorizuar, duke përfshirë të gjitha shtesat dhe ndryshimet në to, dhe marrëveshjet dhe masat ekzistuese për sigurinë.

9.2 Informacioni i dhënë nga një pjesëmarrës ose SN-ja e një pjesëmarrësi tjetër në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një pjesëmarrës ose SN, i cili kërkon konfidencialitet ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikim që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklarimit, të barabartë me atë që kërkohej nga pjesëmarrësi ose SN-ja.

9.3 Çdo pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjithë hapat e ligjshëm të mundshëm për të ruajtur nga deklarimi të gjithë informacionin e shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur Pjesëmarrësit ose SN-të bien dakord me këtë deklarim.

9.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo pjesëmarrës ose SN e shënon këtë informacion të dhënë pjesëmarrësit tjetër në mirëbesim me një legjendë që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklarimit, që informacioni lidhet me një Operacion të NATO-s dhe që është dhënë në mirëbesim.

9.5 Vizitat nga personeli do të rregullohen në pajtim me procedurat e specifikuar në C-M (2002) 49, i ndryshuar.

9.6 I gjithë informacioni i klasifikuar, objekt i dispozitave të këtij seksioni, do të vazhdojë të mbrohet në rast tërheqjeje të çdo pjesëmarrësi ose pas pushimit të fuqisë së MoU-së.

SEKSIONI I DHJETË

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

10.1 Ky MOU hyn në fuqi në datën e njoftimit me shkrim nga Dukati i Madh i Luksemburgut, në lidhje me përfundimin e procedurave të brendshme për hyrjen e tij në fuqi dhe mbetet në fuqi përveç se kur përfundon nga një pjesëmarrës, duke bërë një

njoftim, me afat gjashtë muaj, me shkrim, drejtuar të gjithë Pjesëmarrësve të tjerë.

10.2 Të gjitha dispozitat e seksioneve 6, 7 dhe 9 mbeten në fuqi në rastin e tërheqjes së një pjesëmarrësi ose pas përfundimit të këtij MOU-i deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. SN-të përmbushin të gjitha detyrimet në rastin e përfundimit ose tërheqjes.

SEKSIONI I NJËMBËDHJETË

Ndryshimi dhe interpretimi

11.1 Ky MOU mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim, me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë Pjesëmarrësve. Ndryshimet ose modifikimet hyjnë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim nga Dukati i Madh i Luksemburgut për përfundimin e procedurave të brendshme për hyrjen e tyre në fuqi.

11.2 Konfliktet e dukshme në interpretimin dhe zbatimin e këtij MOU-i zgjidhen me konsultime ndërmjet Palëve, në nivelin më të ulët të mundshëm, dhe nuk i referohen asnjë tribunali kombëtar ose ndërkombëtar apo pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Ky MOU është nënshkruar në tri kopje, ku secili ka tekstin në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja versionet janë njëllor autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në lidhje me interpretimin e tyre, teksti i versionit në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Sa më sipër, përfaqëson marrëveshjet e arritura ndërmjet qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Shtabit Suprem, Komandës Supreme Aleate për Transformimin dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, për çështjet e referuara në të.

Nënshkruar:

Për Qeverinë e Dukatit të Madh të Luksemburgut

(Nënshkrimi)

Etienne Schneider

Ministër i Mbrojtjes

Datë: 18.12.2017

Luxemburg City, Luksemburg

Për Shtabin Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe për Shtabin Komanda Supreme Aleate për Transformimin

(Nënshkrimi, vula)



Markus Kneip
Gjeneral, DEU A
Shef Shtabi
Datë: 8.2.18
Mons, Belgjikë

Aneksi A

Dokumentet e referuara

- a) Traktati Atlantik Verior, i datës 4 prill 1949.
- b) Marrëveshja ndërmjet palëve të Traktatit Atlantik Verior, në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA), të datës 19 qershor 1951.
- c) Protokollin mbi Statusin e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në pajtim me Traktatin Atlantik Verior (Protokollin i Parisit), i datës 28 gusht 1952.
- d) Marrëveshja ndërmjet shteteve palë të Traktatit Atlantik Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995.
- e) Protokollin Shtesë i Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë të Traktatit Atlantik Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokollin Shtesë i PfP SOFA), i datës 19 qershor 1995.

f) Protokollin Tjetër Shtesë i marrëveshjes ndërmjet shteteve palë të Traktatit Atlantik Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokollin Tjetër Shtesë), i datës 19 dhjetor 1997.

g) MC 319/2 – Parimet dhe politikat e NATO-s për Logjistikën.

h) MC 334/2 – Parimet dhe politikat e NATO-s për Mbështetjen e Shtetit Pritës (HNS).

i) NATO STANAG-e të zbatueshme dhe Direktivat Politike për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcës dhe Rimbursimin Financiar.

j) C-M (2002) 49 – Siguria brenda NATO-s, datë 17 qershor 2002.

k) Direktiva BI-SC 15-3 – Përgatitja e marrëveshjeve ndërkombëtare.

l) AJP-4.5 (B) – Doktrina e Përbashkët Aleate për Mbështetjen dhe Procedurat e Shtetit Pritës.

m) CM (2002) 50 – Masat e mbrojtjes për organet civile dhe ushtarake të NATO-s, forcat dhe instalimet (objektet) e dislokuara të NATO-s, kundër sulmeve terroriste.

n) BI-SC – Direktiva e Mbrojtjes së Forcës 80-25, 1 janar 2003.

o) BI-SC – Udhëzuesi për Planifikimin Funkcional për Mbrojtjen e Forcës.

p) AAP-6 – Fjalori i NATO-s, i termave dhe përkufizimeve.

Shtojca 3

SH/OLA/RLB/139/2020

Datë 21 shtator 2020

NOTË ADERIMI/DEKLARIM SYNIMI

PËR TË MARRË PJESË NË MBËSHTETJEN E SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË FINANCIARE DHE TË TJERA TË CAKTUARA BRENDË _____ PËR OPERACIONIN/STËRVITJEN DHE AKTIVITETE TË NGJASHME USHTARAKE

Republika/Mbretëria/Qeveria/Ministri/Ministria e (SN), i/e përfaqësuar nga _____, *pasi* ka vendosur që forcat e saj të armatosura do të marrin pjesë në operacionin/stërvitjen në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë, të miratuar nga Këshilli i Atlantikut Verior;

duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të operacionit/stërvitjes së NATO-s brenda doktrinës së NATO-s; dhe

me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të _____ (Shteti Pritës), Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropës (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe shtetet e tjera dërguese, në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë stërvitjeve dhe operacioneve në lidhje me aktivitetet për Planin e Veprimit të Gatishmërisë,

zgjedh të marrë pjesë dhe të respektojë dispozitat e përfshira në:



Memorandumin e Mirëkuptimit (MOU) ndërmjet Republikës/Mbretërisë/Qeverisë/Ministritë/Ministritë së Mbrojtjes të _____ (HN) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin dhe Komandës Supreme të Komandës së Aleatëve në Evropë, në lidhje me dhënien e mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë ekzekutimit të operacioneve/stërvitjeve/aktiviteteve të tjera të ngjashme ushtarake të NATO-s _____ që ka hyrë në fuqi më _____, si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për aktivitetet ushtarake, në lidhje me këto ndërmarrje, për Planin e Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet MOU-së të lartpërmendur.

Për Republikën/Mbretërinë/Qeverinë/Ministrin/Ministrinë

..... (SN)

.....

.....

Datë:

Shënim. Kjo pjesë është e nevojshme vetëm nëse SN-ja jep SOI-në me rezerva. Atëherë, HN-ja duhet të bjerë dakord me ato rezerva, duke nënshkruar SOI-në dhe duke ia kthyer SN-së për konfirmim.

Shteti Pritës jep/nuk jep mbështetje për Forcat e Armatosura të qeverisë së (SN), që marrin pjesë në aktivitetet ushtarake të NATO-s, në lidhje me këto ndërmarrje në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë sipas dispozitave të HNS MOU-së dhe rezervat e (SN)

Për Republikën/Mbretërinë/Qeverinë/Ministrin/Ministrinë

..... (HN)

.....

.....

Datë

NOTË ADERIMI

PËR PJESËMARRJE NË MBËSHTETJEN E
SHTETIT PRITËS DHE PËRGJEGJËSITË
FINANCIARE, DHE PËRGJEGJËSI TË
TJERA TË VENDOSURA BRENDË
DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT
(HN), PËR OPERACIONE/STËRVITJE DHE
AKTIVITETE TË NGJASHME USHTARAKE

Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar Shqiptar në SHAPE, Kolonel Petrit Çuni,

pasi ka vendosur që forcat e saj të armatosura të marrin pjesë në stërvitje dhe/ose operacione në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë të miratuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut;

duke marrë parasysh konceptin e përgjithshëm të operacionit/stërvitjes së NATO-s brenda doktrinës së NATO-s; dhe

me dëshirën për të marrë pjesë në marrëveshjet, në lidhje me mbështetjen e Vendit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe përgjegjësi të tjera të Dukatit të Madh të Luksemburgut (Vendi Pritës), Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe vendet

e tjera dërguese, në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë stërvitjeve dhe operacioneve për aktivitete të lidhura me Planin e Veprimit të Gatishmërisë,

zgjedh të marrë pjesë dhe të respektojë dispozitat e rregulluara në:

Memorandumin e Mirëkuptimit (MOU) ndërmjet qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, në lidhje me dhënien e mbështetjes së Shtetit Pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve/aktiviteteve të ngjashme ushtarake të NATO-s, i cili ka hyrë në fuqi më 4 maj 2020, si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për aktivitete ushtarake mbi sipërmarrjet që lidhen me Planin e Veprimit të Gatishmërisë, nëpërmjet Memorandumit të Mirëkuptimit të lartpërmendur.

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë (SN):

Kolonel Petrit Çuni

ALB NMR për SHAPE

Datë 26 nëntor 2021

Nënshkrimi, vula



VENDIM
Nr. 149, datë 11.3.2022

**PËR MIRATIMIN E NOTËS SË
 ADERIMIT, PËR T’U BËRË PJESË NË
 MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT,
 NDËRMJET QEVERISË SË MALIT TË ZI
 DHE SHTABIT SUPREM TË FUQIVE
 ALEATE NË EVROPË DHE SHTABIT
 TË KOMANDËS SUPREME ALEATE
 PËR TRANSFORMIMIN, NË LIDHJE
 ME DHËNIEN E MBËSHTETJES SË
 SHTETIT PRITËS PËR EKZEKUTIMIN
 E OPERACIONEVE/STËRVITJEVE TË
 ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË
 ATLANTIKUT VERIOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e notës së aderimit, për t’u bërë pjesë në memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Malit të Zi dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për ekzekutimin e operacioneve/stërvitjeve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

NATO E PAKLASIFIKUAR
Lejuar për Pfp-në

SHTOJCË 2 TEK
 SH/OLA/RLB/139/2020
 Data 21 shtator 2020
TT 207597

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
 NDËRMJET QEVERISË SË MALIT TË ZI
 DHE SHTABIT SUPREM TË FUQIVE
 ALEATE NË EVROPË DHE SHTABIT
 TË KOMANDËS SUPREME ALEATE,
 PËR TRANSFORMIMIN NË LIDHJE ME
 DHËNIEN E MBËSHTETJES SË
 SHTETIT PRITËS PËR EKZEKUTIMIN
 E OPERACIONEVE/STËRVITJEVE TË
 ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË
 ATLANTIKUT VERIOR**

Lejuar për Pfp-në
NATO E PAKLASIFIKUAR

Qeveria e Malit të Zi, e përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Shtabi Suprem i Fuqive Aleatëve në Evropë (SHAPE) dhe Shtabi i Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT), në vijim të referuar si “Pjesëmarrësit”:

duke pasur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut Verior në Uashington, më 4 prill 1949, dhe, veçanërisht, nenin 3 të saj;

duke pasur parasysh Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe të lëshuar nga kryetarët e shteteve dhe qeveritë pjesëmarrëse në Mbledhjen e Këshillit të Atlantikut Verior (Dokumenti Kuadër) të datës 10 janar 1994;

duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë në Traktatin Atlantik Verior dhe Shteteve të Tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (Pfp SOFA), të datës 19 qershor 1995, dhe duke përfshirë Protokollin Shtesë të kësaj Marrëveshjeje, të datës 19 qershor 1995;

duke pasur parasysh dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Palëve në Traktatin Atlantik Verior në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951;

duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Komandës Ushtarake Ndërkombëtare të



themeluar, në pajtim me Traktatin Atlantik Verior (Protokolli i Parisit) të datës 28 gusht 1952;

duke pasur parasysh dispozitat e Protokollit Tjetër Shtesë të Marrëveshjes ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut Verior dhe Shteteve Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (Protokolli Tjetër Shtesë) të datës 19 dhjetor 1997;

duke pasur parasysh konceptin e angazhimit të forcave të NATO-s dhe të forcave të koalicionit nën komandën e NATO-s dhe kontrollit të ose nëpërmjet territorit të Malit të Zi gjatë periudhave të paqes, krizës, emergjencës dhe konfliktit në mbështetje të Operacioneve të NATO-s;

duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve që parashikohen të ndodhin me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forcave të tjera të udhëhequra nga NATO-ja;

dhe duke marrë parasysh nevojat e Malit të Zi, që në vijim referohet si “Shteti Pritës” dhe nevojat e Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe, në vijim e referuar si “Komanda Strategjike”,

kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

SEKSIONI I PARË PËRKUFIZIME

Për qëllimet e këtij MOU-i dhe dokumenteve mbështetës, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1.1 “Forca” – të gjithë komponentët e forcës së udhëhequr nga NATO-ja, që përfshin të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe rezervat, së bashku me çdo komponent tjetër civil të këtyre forcave, siç përkufizohen në NATO SOFA, Protokollin e Parisit dhe ekuivalentët e PfP-së. Forcat e NATO-s përfshijnë, gjithashtu, çdo forcë (personel, kafshë, materiale dhe rezerva etj.) nga çdo shtet i autorizuar nga Këshilli Atlantik Verior për të marrë pjesë në stërvitje ose operacion. Termi përfshin, gjithashtu, të gjitha anijet, avionët, automjetet, magazinat, pajisjet dhe municionin, si dhe burimet e lëvizjes në ajër, tokë dhe det, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse.

1.2 “Operacionet e NATO-s” – veprimet ushtarake, duke përfshirë stërvitjen ose kryerja e misioneve ushtarake strategjike, taktike, të shërbimit, trajnuese ose administrative të kryera nga forcat; procesi i zhvillimit të luftimit, duke

përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e çdo lufte ose fushatë.

1.3 “Komandant i NATO-s” – një komandant ushtarak në zinxhirin e komandës së NATO-s.

1.4 “Organizatave të NATO-s” – komandat ose njësitë e organizuara të forcave nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 “Komanda Ndërkombëtare” – Komanda Ushtarake Ndërkombëtare në strukturat e integruara të komandës së NATO-s. Përfshin aktivitetet që mund të jenë detashmente të përkohshme ose njësi të komandave.

1.6 “Komanda Kombëtare” – komandat e forcave kombëtare në komandën dhe në kontrollin e NATO-s.

1.7 “Komanda Shumëkombëshe” – komanda me personel nga më shumë se një shtet që formohen me marrëveshjen e shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 “Shtet Dërgues (SN)” – ato shtete dhe Komanda ose elementët e tyre që angazhohen në territorin e SP-së në mbështetje të operacioneve të NATO-s.

1.9 “Shtet Pritës (SP)” – Mali i Zi.

1.10 “Komanda ose Komandantët Strategjikë (KK)” – Komandanti Suprem i Aleatëve në Evropë (SACEUR), Komanda Supreme e Aleatëve për Transformimin (SACT) dhe selia e së cilës është përkatësisht HQ SHAPE dhe HQ SACT.

1.11 “Mbështetje e Shtetit Pritës (HNS)” – asistencë civile dhe ushtarake, që u jepet në paqe, emergjencë, situata krize ose periudha tensioni ndërkombëtar ose konflikt nga një Shtet Pritës, forcave dhe organizatave aleate që ndodhen, operojnë ose kalojnë tranzit përmes territorit, ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të Shtetit Pritës.

1.12 “Mbrojtja e Forcës (FP)” – të gjitha masat e marra dhe mjetet që përdoren për të minimizuar vulnerabilitetin e personelit, mjediseve, pajisjeve dhe operacioneve ndaj çdo rreziku në të gjitha situatat, për të ruajtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcës.

1.13 “Shpenzimet” – ato shpenzime që shoqërohen me ngritjen, mbështetjen dhe mbajtjen e komandave, forcave kombëtare, shumëkombëshe ose ndërkombëtare, forcave ose organizatave të



NATO-s. Për qëllimet e këtij MOU-i dhe dokumenteve të tij mbështetëse:

a) “Shpenzimet e Zakonshme të NATO-s” – ato shpenzime për të cilat bihet dakord të jenë përgjegjësi e përbashkët e Aleancës.

b) “Shpenzime të Përbashkëta” – ato shpenzime për të cilat bihet dakord paraprakisht të jenë përgjegjësi e përbashkët e më shumë se një shteti. Masat e Shpenzimeve të Përbashkëta bazohen zakonisht në një formulë të detajuar në Marrëveshjet Teknike dhe/ose Marrëveshjet e Përbashkëta të Zbatimit.

c) “Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare” – ato shpenzime që konsiderohen të jenë përgjegjësi e një SP-je të vetëm.

1.14 “Financim i Përbashkët i NATO-s” – fondet e dhëna nga shtetet e NATO-s dhe që ofrohen me miratimin nëpërmjet buxheteve të NATO-s për Shpenzimet e Zakonshme që shkaktohen gjatë zhvillimit të Operacioneve ose Stërvitjeve të specifikuara në të.

1.15 “Notë Pranimi (N0A)” – një dokument që tregon synimin e një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në, sipas dispozitave të këtij MOU-i për një operacion të specifikuar të udhëhequr nga NATO.

1.16 Deklaratë Synimi (S01) – një dokument që tregon një synim të një SN-je për të marrë pjesë në masat për HNS-në, sipas dispozitave të këtij MOU-i, por duke iu nënshtruar rezervave të caktuara specifike. HN-ja konfirmon nëse rezervat janë të pranueshme apo jo për dhënien e HSN-së.

1.17 “Masë Teknike (TA)” – një masë pasuese bilaterale e këtij MOU-i për një Operacion të specifikuar të NATO-s. Ajo detajon përgjegjësitë dhe procedurat për dispozitat e HNS-së nga HN-ja ndaj Komandantit të NATO-së dhe SN-ve.

1.18 “Masë e Përbashkët Zbatimi (JIA)” – një masë pasuese bilaterale që vendos angazhimin ndërmjet palëve, në lidhje me dhënien dhe marrjen e HNS-së. Kjo përfshin informacionin e hollësishëm për mbështetjen e kërkuar dhe të ofruar, procedurat e specifikuara të vendit për zbatimin dhe rimbursimin ose kushtet e pagesës.

1.19 “Komitet Drejtues i Mbështetjes së Përbashkët i Shtetit Pritës (JHNSSC)” – një komitet i ngritur në mënyrë të posaçme dhe i bashkëkryesuar nga HN-ja dhe Komandanti i NATO-s. Komiteti, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar nga të gjithë SN-të, HN-ja dhe

Komandanti/ët e NATO-s takohen për të zhvilluar masat e nevojshme përmirësuese, në lidhje me HNS-në, si TA-ja dhe JIA-të, sipas rastit.

1.20 “Vendet Operacionale” – vendet që gjenden në territorin e HN-së për qëllimin e mbështetjes operacionale dhe/ose logjistike për forcën për operacionet ose stërvitjet e NATO-s. Këto vende janë detashmente të një Komandë Strategjike nën komandën dhe kontrollin e Komandantit të NATO-s.

1.21 Përveç kur një kuptim specifikohet ndryshe në këtë MOU, zbatohet fjalori i NATO-s për termat dhe përkufizimet (AAP-6).

SEKSIONI I DYTË QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij MOU-i është vendosja e politikës dhe e procedurave për përcaktimin e vendeve operacionale dhe ofrimin e HNS-së të forcat e NATO-s ose të mbështetur nga HN-ja gjatë operacioneve të NATO-s.

2.2 Ky MOU dhe dokumentet e tij pasuese synohet të shërbejnë si bazë për planifikimin nga autoriteti përkatës i HN-së dhe nga komandantët e NATO-s, duke parashikuar masat e HNS-së për një sërë operacionesh të NATO-s. Këto misione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e angazhuara dhe ato për të cilat duhet të identifikohen forcat.

SEKSIONI I TRETË OBJEKTI DHE MASA TË PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO SOFA ose Pfp SOFA, Protokollit të Parisit dhe Protokollit Tjetër Shtesë dhe çdo dispozitë tjetër përkatëse e Marrëveshjes, që mund të jenë në fuqi ndërmjet SC-ve dhe HN-së, zbatohen për të gjitha operacionet e NATO-s.

3.2 HN-ja njihet vendet operacionale të krijuara në zbatimin e këtij MOU-i si detashmente të SC-së krijuese dhe aktivitetet e këtyre detashmenteve të jenë ndërmarrje të SC-së. Këto vende që duhet të vendosen, identifikohen në dokumente pasuese. Masat e komandës dhe të kontrollit do të caktohen në planet përkatëse operacionale.

3.3 Ky MOU synon të jetë në pajtim me doktrinën dhe politikën e NATO-s dhe ofron një masë dhe strukturë ombrellë për HNS-në.



3.4 HN-ja do të japë mbështetje brenda kapacitetit të tij të plotë, duke iu nënshtruar disponibilitetit dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave që ekzistojnë për momentin, për forcat e angazhuara në operacionet e NATO-s. Hollësitë e kësaj mbështetjeje do të trajtohen në dokumente shtesë.

3.5 Dispozitat e këtij MOU-i zbatohen në paqe, emergjencë, krizë dhe konflikte ose periudha të tensionit ndërkombëtar, siç mund të përcaktohet reciprokisht nga HN-ja dhe autoritetet përkatëse të NATO-s.

3.6 Ndërsa SN-të dërguese inkurajohen të marrin pjesë në operacionet e NATO-s dhe të pranojnë dispozitat e këtij MOU-i, si një dokument ombrellë, sipas të cilit HNS-ja jepet nga HN-ja, marrëveshjet e veçanta bilaterale me shtetet individuale mund të merren parasysh nga HN-ja rast pas rasti.

3.7 HN-ja dhe SC-të mund të caktojnë përfaqësues për të negociuar dokumentet që mbështesin dhe përmirësojnë këtë MOU.

3.8 Operacionet e NATO-s të mbështetura nga ky MOU mund të kërkojnë operacione ajrore të mbështetjes shumëkombëshe me avionë dhe helikopterë, dhe në rastin e porteve, me anije mbështetëse ushtarake dhe mallrash. HN-ja njihet që lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre, në dhe përmes zonave territoriale të HN-së, do të kryhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e Operacionit. HN-ja do të administrojë/kontrollojë të gjitha aspektet e një lejeje të tillë.

SEKSIONI I KATËRT DOKUMENTET REFERUESE

4.1 Dokumentet referuese që mund të jenë të zbatueshme për këtë MOU, gjenden tek aneksi A.

SEKSIONI I PESTË PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij MOU-i

5.1 SHITESI PRITËS

a) Gjatë hartimit të dokumenteve mbështetëse dhe me ndodhjen e ndryshimeve dhe pas përfundimit të këtyre dokumenteve, HN-ja kryen njoftim në kohën e duhur për Komandantin e NATO-s në lidhje me disponibilitetin ose ndonjë

mangësi të aftësive të HNS-së. HN-ja merr parasysh që planifikuesit e NATO-s bazohen te dokumentet mbështetëse të hartuara për këtë MOU dhe kërkojnë një njoftim në kohë për ndryshimet e planifikuara për strukturat dhe aftësitë kombëtare.

b) Me qëllim që të ofrohet mbështetje, HN-ja merr masat e nevojshme për burimet e mbështetjes për të përfshirë burimet civile dhe tregtare. Mbështetja e siguruar me prokurim përftohet nëpërmjet një procesi ofertimi konkurrues nga ofertuesi më i ulët i përshtatshëm.

c) HN-ja mban regjistrat administrativë dhe financiarë të nevojshëm për të realizuar rimbursimin e HN-së për burimet e dhëna për forcat. Regjistrat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxheti i NATO-s ofrohen për NATO-n, siç kërkohej nga qëllimet e auditimit.

d) Standardet e mallrave dhe të shërbimeve të dhëna nga HN-ja do të jenë në pajtim me hollësitë e përcaktuara te dokumentet mbështetëse.

e) HN-ja do të ruajë kontrollin mbi burimet e veta të HNS-së, përveç kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) HN-ja do të ofrojë, para çdo operacioni të NATO-s, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar të HNS-së.

g) HN-ja do të ftojë SN-të të pranojnë dispozitat e këtij MOU-i, nëpërmjet një NOA-je se SOI-je.

h) HN-ja i ofron forcës procedurat për ndërmjetësimin mjekësor ndërmjet HN-së dhe SN-së, duke përfshirë pikat mjekësore të kontaktit (POCs).

i) HN-ja, në bashkërendim me Komandantin e NATO-s, i ofron forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli/mjediset ushtarake të HN-së, në të njëjtat kushte që u jepet edhe Forcave të Armatosura të HN-së.

j) Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse, HN-ja do t'i ofrojë Komandantit të NATO-s dhe SN-ve kopje të çdo rregulloreje shëndetësore, sigurie, mjedisore dhe bujqësore, që mund të zbatohen për operacionin e NATO-s, si dhe çdo rregullore, në lidhje me ruajtjen, lëvizjen ose disponimin e materialeve të rrezikshme.

5.2 KOMANDANTI I NATO-S

a) Komandanti i NATO-s garanton, në masën maksimale të mundshme, që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, sasinë dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Vihet re që



struktura e misionit dhe e forcës që përcaktohet për një Plan Operacional (OPLAN), një Urdhër Operacional (OPORD) ose një Urdhër Operacional Stërvitor (EXOPORD) nuk mund të specifikohet para kohe. Komandanti i NATO-s jep informacionin e nevojshëm shtesë për planifikimin e HN-së sa më shpejt të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s i bën HN-së njoftim, në kohë në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave dhe propozon modifikimin e dokumenteve mbështetëse, sipas rastit.

c) Komandanti i NATO-s përcakton nëse ofrohet Financimi i Zakonshëm dhe cilat kërkesa janë të përshtatshme për Financim të Zakonshëm.

d) Komandanti i NATO-s përcakton dhe vendos prioritetet e kërkuara HNS-ë dhe miraton çmimet, në lidhje me Shpenzimet e Zakonshme.

e) Komandanti i NATO-s garanton rimbursimin financiar për HN-në për HNS-të e rëna dakord, nëse paguhet nga Financimi i Zakonshëm. Në të gjitha rastet e tjera, Komandanti i NATO-s ndihmon, në masën që është e nevojshme, në përmbushjen e detyrimeve financiare ndërmjet HN-së dhe SN-ve.

f) Nëse kërkesat e SN-ve bien në konflikt me prioritetet e Komandantit të NATO-s për shpërndarjen e burimeve, Komandanti përkatës i NATO-s e zgjidh konfliktin me SN-të e përfshira.

g) Komandanti i NATO-s identifikon personelin dhe kërkesat e tjera për Operacionin e vendeve që caktohen në HN.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe të kostos së mbështetjes gjatë negociatave dhe/ose të JHNSSC-ja.

5.3 SHTETET DËRGUESE

a) SN-të mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për HNS-në,

duke pranuar dispozitat e këtij MOU-i nëpërmjet një NOA-je ose duke nxjerrë një SOI për një operacion të caktuar të NATO-s.

b) SN-të identifikojnë kërkesat e HNS-së ndaj HN-së dhe Komandantit përkatës të NATO-s.

c) Për kërkesat e Kostos së Drejtpërdrejtë Kombëtare, SN-ja normalisht merr pjesë në negociatat për HNS-të gjatë JHNSSC-së ose drejtpërdrejt me HN-në, nëse nuk krijohet një JHNSSC. SN-të ofrojnë pagesën e drejtpërdrejtë ose rimbursimin për HNS-të ndaj HN-së vetëm për shërbimet e dhëna nga HN-ja, përveç kur

përdoren, siç është rënë dakord, procedura të tjera pagese. Sipas masave kontraktuale të marra nga HN-ja dhe SN-të, mbështetja e dhënë nga burimet tregtare ose civile paguhet drejtpërdrejt nga SN-të.

d) SN-të ofrojnë personel të përshtatshëm të autorizuar për të marrë pjesë në diskutimet e HNS-së gjatë JHNSSC-së, nëse krijohet.

e) SN-të do të raportojnë ndryshimet e kërkesave HNS të HN-ja dhe Komandanti përkatës i NATO-s, kur ato kryhen, dhe paraqet kërkesat e rishikuara dhe/ose situacionet.

f) SN-të janë përgjegjëse për shpenzimet e çdo shërbimi mjekësor ose dentar të dhënë nga HN-ja.

g) SN-të duhet të respektojnë rregulloret dhe procedurat e HN-së për shëndetin, sigurinë, mjedisin dhe bujqësinë, që janë identifikuar për vendet operacionale, si dhe çdo rregullore të HN-së për ruajtjen, lëvizjen ose disponimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI I GJASHTË DISPOZITA FINANCIARE

6.1 Me marrëveshje të ndërsjellë dhe/ose konventa ndërkombëtare, aktivitetet e Komandave Ndërkombëtare, vendet operacionale, anijet, avionët ose automjetet në pronësi dhe/ose të kontraktuara nga NATO-ja, POL-së dhe forcat e ofruara NATO-s janë të përjashtuara nga tatimet, detyrimet, pagesat shtetërore, tarifatat dhe të gjitha pagesat e ngjashme.

6.2 Protokoli i Parisit, Protokoli Tjetër Shtesë dhe e drejta zakonore ndërkombëtare që plotëson imunitet dhe privilegjet në lidhje me Shtabet e Aleatëve, do të zbatohen për çdo Komandë Ndërkombëtare, element ose detashment të komandës që mund të vendosen në HN, pas zbatimit të një operacioni të drejtuar nga NATO-ja.

6.3 Nëse përjashtimi i plotë nga tatimet, detyrimet, tarifatat ose pagesat e ngjashme nuk është i mundur, detyrimet nuk vendosen në një normë më të lartë se sa ajo që zbatohet për Forcat e Armatosura të HN-së. Të gjitha shpenzimet duhet të përpunohen me shumën më të ulët që shoqëron kërkesat administrative.

6.4 Transaksionet financiare që përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive në çdo institucion bankar privat ose qeveritar, duhet të kryhen pa marrë asnjë pagesë apo tarifë të asnjë lloji.



6.5 Masat përfundimtare financiare, veçanërisht ato në lidhje me Financimin e Zakonshëm të NATO-s, do të vendosen vetëm para zbatimit të Operacionit të NATO-s. Të gjitha masat financiare që negocohen paraprakisht duhet të jenë specifike, në lidhje me detyrimet financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet për të cilat nuk bihet specifikisht dakord që të jenë shpenzime të financuara nga NATO-ja, para se të realizohen shpenzimet, nuk marrin Financim të Zakonshëm nga NATO-ja.

6.6 Dokumentet mbështetëse ofrojnë bazën fillestare për vlerësimet e shpenzimeve dhe shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve si Shpenzime të Zakonshme të NATO-s (sipas rastit), Shpenzime të Përbashkëta ose Shpenzime të Drejtpërdrejta Kombëtare.

6.7 Nëse Komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë të përshtatshme dhe të ofrueshme nga Financimi i Zakonshëm i NATO-s (nga alokimet e miratuara të buxhetit), SC-ja autorizon Financimin e Zakonshëm për ato shpenzime dhe i paguan drejtpërdrejt ose rimbursos HN-në.

6.8 Nëse shpenzime të caktuara përcaktohen që t'i takojnë më shumë se një shteti, këto shpenzime mund të identifikohen si Shpenzime të Përbashkëta dhe nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët të shteteve të përfshirë, mund të ndahen në pajtim me formulën e ndarjes së shpenzimeve të miratuara në dokumente të tjera mbështetëse.

6.9 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të dhëna nga HN-ja nuk vendosen me një normë më të lartë se sa ato që u ngarkohen Forcave të Armatosura të HN-së dhe nuk përfshijnë shpenzime të tepërta administrative ose të tjera, por mund të reflektojnë përshtatje, për shkak të grafikëve të dorëzimit, pikave të dorëzimit ose konsideratave të ngjashme. Rimbursimi nuk paguhet për mbështetjen e dhënë nga personeli ushtarak.

6.10 Komandanti i NATO-s dhe SN-të mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me furnitorët tregtarë për furnizime, shërbime ose mbështetje tjetër.

6.11 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të SN-së janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të operojnë pa siguracion tregtar.

6.12 HN-ja nuk shkakton asnjë detyrim financiar në emër të Komandantit të NATO-s ose

SN-së, përveç kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë paraprakisht nga një përfaqësues i autorizuar dhe përveç kur është rënë dakord për përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve. Gjithashtu, asnjë fond nuk jepet para se SC-të ose SN-të, sipas rastit, të kenë miratuar dokumentet përkatëse mbështetëse dhe të kenë udhëzuar zbatimin e tyre.

6.13 Nuk është dhënë financim në lidhje me këtë MOU dhe ky dokument nuk përfaqëson ndonjë detyrim specifik financimi nga ana e Komandantit të NATO-s ose SN-ve. Masat e hollësishme financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse të këtij MOU-i.

6.14 Faktimi i vendeve operationale në mbështetje të një operacioni të NATO-s nuk parashikon ndërtim ose rehabilitim infrastrukture.

SEKSIONI I SHTATË KONSIDERATA JURIDIKE

7.1 SC-të realizojnë ose delegojnë veprime juridike që janë thelbësore për përmbushjen e misioneve, duke përfshirë, pa kufizim, në ushtrimin e cilësisë për të lidhur kontrata, angazhuar në procedime gjyqësore ose administrative dhe përftojnë dhe disponojnë mbi pronën.

7.2 Statusi i forcave të angazhuara në territorin e HN-së do të përcaktohet në pajtim me NATO-n ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë.

7.3 Pajisjet, furnizimet, produktet dhe materialet që importohen dhe eksportohen nga territori i HN-së, në lidhje me një operacion të NATO-s, përjashtohen nga detyrimet, tatimet dhe tarifatat. Procedurat e tjera doganore përcaktohen në pajtim me NATO SOFA ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin Tjetër Shtesë.

7.4 Pretendimet jokontraktuale, që rrjedhin ose janë në lidhje me ekzekutimin e këtij MOU-i, trajtohen në pajtim me dispozitat e NATO SOFA ose PfP SOFA.

7.5 Pretendimet kontraktuale trajtohen dhe gjykohen nga HN-ja në pajtim me procedurën e rregullimit të kontratave publike dhe me të drejtën e HN-së, me rimbursim nga Komanda e NATO-s ose SN-ja, sipas rastit.



SEKSIONI I TETË MBROJTJA E FORCËS

8.1 Mbrojtja e Forcës e plotë dhe efektive planifikohet për Komandën statike të NATO-s, operacionet, trajnimin dhe stërvitjet dhe detajohet në OPLANS, Udhëzimet e Planifikimit të Stërvitjeve (EXPIs) ose Masat Pasuese, sipas rastit. Mbrojtja e Forcës zbatohet në pajtim me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në një mënyrë që është në pajtim me NATO/PfP SOFA. Mbrojtja e Forcës nuk kërkohet, në asnjë rrethanë, të jetë në kundërshtim me NATO PfP SOFA ose ligjet e HN-së.

8.2 Sipas rastit, HN-ja do të informojë SN-në dhe Komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara për FP-në.

8.3 Sipas rastit, çdo SN është përgjegjëse për identifikimin dhe parashikimin e kërkesave dhe kufizimeve të mbrojtjes së forcës të HN-ja dhe Komandanti i NATO-s.

8.4 Përveç këtyre përgjegjësive për mbrojtjen e forcës, të detajuara në politikën dhe procedurat e NATO-s për mbrojtjen e forcës, Komandanti i NATO-s është përgjegjës për bashkërendimin e për gjithçka kërkohet dhe paraqitet për HN-në dhe SN FP-në, sipas rastit, për mbrojtjen e Forcës së tij.

SEKSIONI I NËNTË SIGURIA DHE DEKLARIMI I INFORMACIONIT

9.1 Pjesëmarrësit dhe SN-të përmbushin procedurat e NATO-s për sigurinë në ruajtjen, trajtimin, transmetimin dhe garantimin e të gjithë materialit të klasifikuar që mbahet, përdoret, gjenerohet, ofrohet ose shkëmbehet.

9.2 Informacioni i dhënë nga një pjesëmarrës ose SN një tjetri në mirëbesim dhe çdo informacion i tillë i nxjerrë nga një pjesëmarrës ose SN, i cili kërkon konfidencialitet, ruan klasifikimin e tij origjinal ose i caktohet një klasifikimi që garanton një shkallë të mbrojtjes ndaj deklaramit, të barabartë me atë që kërkohet nga pjesëmarrësi ose SN-ja.

9.3 Çdo Pjesëmarrës dhe SN ndërmerr të gjithë hapat e ligjshëm të mundshëm për të ruajtur nga deklarimi të gjithë informacionin e shkëmbyer në mirëbesim, përveç kur pjesëmarrësit ose SN-të bien dakord me këtë deklaram.

9.4 Për të ndihmuar në dhënien e mbrojtjes së dëshiruar, çdo Pjesëmarrës ose SN ia shënon këtë informacion të dhënë tjetrit në mirëbesim, me një legjendë, që tregon origjinën, klasifikimin e sigurisë dhe kushtet e tij të deklaramit që informacioni lidhet me një operacion të NATO-s dhe që është dhënë në mirëbesim.

9.5 Vizitat nga personeli do të rregullohen në pajtim me procedurat e specifikuar në C-M(2002)49, i ndryshuar.

SEKSIONI I DHJETË HYRJA NË FUQI, KOHËZGJATJA DHE PRISHJA

10.1 Ky MOU hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të dhe mbetet në fuqi, përveç kur prishet nga një Pjesëmarrës, duke bërë një njoftim me afat gjashtë muaj me shkrim drejtuar të gjithë Pjesëmarrësve të tjerë.

10.2 Të gjitha dispozitat e seksioneve 6, 7 dhe 9 mbeten në fuqi në rastin e tërheqjes së një Pjesëmarrësi ose pas prishjes së këtij MOU-i deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. SN-të përmbushin të gjitha detyrimet në rastin e prishjes ose tërheqjes.

SEKSIONI I NJËMBËDHJETË NDRYSHIMI DHE INTERPRETIMI

11.1 Ky MOU-i mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë Pjesëmarrësve.

11.2 Konfliktet e dukshme në interpretimin dhe zbatimin e këtij MOU-i zgjidhen me konsultime ndërmjet Palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk i referohet asnjë tribunali kombëtar ose ndërkombëtar apo pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Ky MOU-i është nënshkruar në tri kopje, ku secili ka tekstin në gjuhën angleze.

11.4 Në rast mospërputhjeje në interpretimin të këtij MOU-i, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Sa më sipër përfaqëson marrëveshjet e arritura ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi, Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë, Komandës Supreme të Aleatëve për Transformimin, për çështjet e referuara në të.

**Për Malin e Zi***(nënshkrimi)*

Emri: Boro Vucinic M.A.

Titulli/gradë: Ministër i Mbrojtjes

Datë 22.8.2009

Podgoricë, Mali i Zi

**Në emër të Komandës Supreme të Fuqive
Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës
Supreme Aleate për Transformimin**

(nënshkrimi)

Karl-Heinz Lather

Gjeneral, DEU A

Shef Shtabi

Datë 13 tetor 2009

Mons, Belgjikë

SHTOJCË

A. Dokumentet e Referencës

B. Notë Aderimi (NOA). Deklaratë Synimi (SOI)

ANEKSI A

MOU

Datë shtator 09

DOKUMENTET E REFERUARA

a) Traktati Atlantik Verior i datës 4 prill 1949;

b) Dokumenti Kuadër i Partneritetit për Paqe i nxjerrë nga krerët e Shteteve dhe Qeveritë Pjesëmarrëse në Takimin e Këshillit të Atlantikut Verior (Dokument i Kuadër), i datës 10 janar 1994;

c) Marrëveshje ndërmjet Palëve të Traktatit Atlantik Verior në Lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA) të datës 19 qershor 1951;

d) Marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit Atlantik Verior dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me Statusin Forcave të tyre (PfP SOFA), të datës 19 qershor 1995;

e) Protokoll Tjetër Shtesë për Marrëveshjen ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit Atlantik Verior

dhe Shteteve të tjerë Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me Statusin Forcave të tyre (Protokoll Tjetër Shtesë), i datës 19 dhjetor 1997;

f) Protokoll i mbi Statusin e Komandave Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në pajtim me Traktatin Atlantik Verior (Protokoll i Parisit), i datës 28 gusht 1952;

g) MC 36/2 – Ndarja e Përgjegjësve në Kohë Luftë ndërmjet Komandantëve Kombëtarë dhe Komandantëve Madhorë të Varur të Aleatëve;

h) MC 317 – Struktura e Forcës së NATO-s;

i) MC 319/1 – Parimet dhe Politikat e NATO-s për Logjistikën;

j) MC 326/1 – Parimet dhe Politikat për Mbështetjen Mjekësore;

k) MC 334/1 – Parimet dhe Politikat e NATO-s për Mbështetjen e Shtetit Pritës (HNS);

l) MC 336/1 – Koncepti i NATO-s për Lëvizjen dhe Transportimin;

m) MC 400/2 – MC Udhëzimi për Zbatimin Ushtarak të Strategjisë së Aleancës;

n) NATO STANAG-e të zbatueshme dhe Direktivat Politike për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcës dhe Rimbursimin Financiar;

o) Koncepti i NATO-s për Operacionet Detare (COMAROPS);

p) ALP-9 – Doktrina e Logjistikës së Forcave Detare;

q) ALP-11 – Logjistika e Forcës Detare Shumëkombëshe;

r) AJP-4.5 – Publikimi i Përbashkët i Aleatëve për Doktrinën dhe Procedurat e Mbështetjes së Shtetit Pritës;

s) ALP-13 – Doktrina e Logjistikës Ajrore;

t) AAP-6 – Fjalori i Termave.

u) Udhëzime për Planifikimin Operacional (GOP);

v) C-M(2002) 49 – Siguria Brenda Organizatës së Traktatit Atlantik Verior;

w) Bi-SC – Direktiva për Stërvitjen 75-3.



ANEKSI B

MOU

DATE shtator 09

**NOTË ADERIMI (NOA)/DEKLARIM SYNIMI (SOI)
PËR TË MARRË PJESË NË MBËSHTETJEN E SHTETIT PRITËS (HNS) DHE
PËRGJEGJËSITË FINANCIARE DHE TË TJERA TË CAKTUARA
BRENDA MALIT TË ZI (HN)**

PËR OPERACIONIN/STËRVITJEN _____

Qeveria..... (SN), e përfaqësuar nga.....,
pasi ka vendosur që Forcat e saj të Armatosura do të marrin pjesë në Operacion/Stërvitje
.....;

duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërvitjes së NATO-s brenda doktrinës së NATO-s dhe me dëshirën për të marrë pjesë në masat në lidhje me Mbështetjen e Shtetit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe të tjera të Republikës së Malit të Zi, Komandës Supreme të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Shtetet e tjerë Dërguese në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë Operacionit të Stërvitjes,

ZGJEDH TË MARRË PJESË DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E PËRFSHIRA NË:

Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Malit të Zi dhe Komandës Supreme të Komandës së Aleatëve në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin në lidhje me dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës gjatë Operacionit/Stërvitjes së NATO-s, që ka hyrë në fuqi më, si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për planifikimin, përgatitjen dhe pjesëmarrjen nëpërmjet MOU-it së lartpërmendur. (Nëse duhet të shprehen rezerva, mund të shtohen fjalët e mëposhtme në fjalë: “në pajtim me rezervat e mëposhtme:” më pas renditen rezervat, sipas rastit.)

Për Qeverinë e.....(SN)

.....
.....
.....

Data:

SHËNIM. KJO PJESË ËSHTË E NEVOJSHME VETËM NËSE SN-ja JEP SOI ME REZERVA. ATËHERË, HN-ja DUHET TË BJERË DAKORD ME ATO REZERVA, DUKE NËNSHKRUAR SOI-në DHE DUKE IA KTHYER SN-së PËR KONFIRMIM

Shteti Pritës jep/nuk jep mbështetje për Forcat e Armatosura të Qeverisë së
(SN), që marrin pjesë në operacion/stërvitje, sipas dispozitave të HNS-së MOU dhe rezervat e (SN).....

Për Qeverinë e Malit të Zi (HN)

.....
.....
.....

Data



**NOTË ADERIMI
PËR PJESËMARRJE NË MBËSHTETJEN
E SHTETIT PRITËS DHE
PËRGJEGJËSITË FINANCIARE DHE
PËRGJEGJËSI TË TJERA TË
VENDOSURA BRENDË QEVERISË SË
MALIT TË ZI (HN) PËR OPERACIONE/
STËRVITJE DHE AKTIVITETE TË
NGJASHME USHTARAKE**

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar Shqiptar në SHAPE, Kolonel Petrit ÇUNI,

pasi ka vendosur që Forcat e saj të Armatosura të marrin pjesë në stërvitje dhe/ose operacione, në lidhje me Planin e Veprimit të Gatishmërisë të miratuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut;

duke marrë parasysh Konceptin e Përgjithshëm të Operacionit/Stërvitjes së NATO-s brenda doktrinës së NATO-s; dhe

me dëshirën për të marrë pjesë në marrëveshjet, në lidhje me Mbështetjen e Vendit Pritës dhe përgjegjësitë financiare dhe përgjegjësi të tjera të Qeverisë së Malit të Zi (Vendi Pritës), Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin (HQ SACT) dhe Vendet e tjera Dërguese, në lidhje me mbështetjen e këtyre forcave të armatosura gjatë stërvitjeve dhe operacioneve për aktivitetet të lidhura me Planin e Veprimit të Gatishmërisë,

ZGJEDH TË MARRË PJESË DHE TË RESPEKTOJË DISPOZITAT E RREGULLUARA NË:

Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë, si dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, në lidhje me dhënien e mbështetjes së shtetit pritës për Ekzekutimin e Operacioneve dhe Stërvitjeve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, i cili hyri në fuqi më 13 tetor 2009, si më poshtë:

Si Shtet Dërgues për operacione dhe stërvitje mbi sipërmarrjet, që lidhen me Planin e Veprimit të Gatishmërisë nëpërmjet Memorandumit të Mirëkuptimit të lartpërmendur.

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë (SN)

Kolonel Petrit ÇUNI

ALB NMR për SHAPE

Datë 26 nëntor 2021

Nënshkrimi, vula

**VENDIM
Nr. 150, datë 11.3.2022**

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
TURQISË PËR BASHKËPUNIMIN NË
FUSHËN E TRAJNIMEVE DHE
ARSIMIMIT, PËR ZBATIMIN E LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin në fushën e trajnimeve dhe arsimimit, për zbatimin e ligjit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË,
PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E
TRAJNIMEVE DHE ARSIMIMIT, PËR
ZBATIMIN E LIGJIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Turqisë, në vijim të referuara individualisht si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët”;



duke dëshiruar të forcojnë dhe zhvillojnë më tej marrëdhëniet miqësore ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë, të nxisin mirëqenien dhe stabilitetin në një mjedis paqësor në të dyja shtetet, në kuadër të parimit të respektimit të ndërsjellë të sovranitetit, barazisë dhe interesit të të dyja Palëve,

kanë rënë dakord për çështjet e mëposhtme në fushën e trajnimit dhe arsimimit, për zbatimin e ligjit.

Neni 1 Përkufizime

Të gjitha përkufizimet e mëposhtme zbatohen brenda objektit të Memorandumit të Mirëkuptimit:

a) **Personel** mund të jetë praktikant dhe/ose trajner, dhe/ose personel i institucioneve të zbatimit të ligjit, në detyrë, që i përket njëres prej palëve;

b) **Student** nënkupton personelin që do të trajnohet në qendrat e trajnimit ose në institucione të tjera përkatëse trajnimi, në emër të forcave të zbatimit të ligjit, por që ende nuk është ngritur në gradë;

c) **Praktikant** nënkupton personelin, instruktorin ose studentin që do të trajnohet brenda fushës së programeve të trajnimit;

d) **Trajner** nënkupton personelin ose instruktorin që do të ofrojë trajnime brenda fushës së programeve të trajnimit;

e) **Kandidat** nënkupton një person që plotëson kushtet e kërkuara për pranim në njësitë e trajnimit, në kuadër të programeve të trajnimit;

f) **Pala Dërguese** nënkupton shtetin që dërgon personel te Pala Pritëse për zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi;

g) **Pala Pritëse** nënkupton shtetin që pranon personelin e Palës Dërguese për zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 2 Qëllimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi synon të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet Palëve në fushën e trajnimit dhe arsimimit për zbatimin e ligjit.

Neni 3 Objekti

Ky Memorandum Mirëkuptimi mbulon procedurat dhe parimet për programet e trajnimit dhe arsimimit në fushat e përcaktuara në nenin 4.

Neni 4 Fushat e bashkëpunimit

Palët do të kryejnë aktivitete bashkëpunimi, trajnimi dhe arsimimi në fushat e mëposhtme:

1. Arsimimi pas diplomimit

Personeli mund të pranohet çdo vit në institutet përkatëse në Akademinë Kombëtare të Policisë/Xhandarmërisë dhe Akademisë së Rojës Bregdetare të Turqisë, sipas fushës, numrit dhe kërkesave që do të shpallen në faqet e internetit të Akademive përkatëse para periudhës së arsimimit.

a) Programet master në fushën e sigurisë publike:

Personat që deklarohen si kandidatë nga vendet e tyre, sipas kërkesave dhe periudhave të publikuara në faqet e internetit: www.pa.edu.tr dhe www.isga.edu.tr, dhe që aplikojnë personalisht, dhe që e kalojnë me sukses intervistën, do të pranohen në programet e studimit të ciklit të dytë, të ofruara nga institutet e lidhura me Akademinë Kombëtare të Policisë /Xhandarmërisë dhe Akademinë e Rojeve Bregdetare të Turqisë.

b) Programet master pa tezë në fushën e sigurisë publike:

Personat që deklarohen si kandidatë nga vendet e tyre, sipas kërkesave dhe periudhave të publikuara në faqet e internetit: www.pa.edu.tr dhe www.isga.edu.tr, dhe që aplikojnë personalisht, dhe që janë të suksesshëm në një intervistë, do të pranohen për programet e arsimit master pa tezë, ofruar nga institutet e lidhura me Akademinë Kombëtare të Policisë Turke/Xhandarmërisë dhe Akademinë e Rojeve Bregdetare.

c) Programet e doktoraturës në fushën e sigurisë publike:

Personat që deklarohen si kandidatë nga vendet e tyre, sipas kërkesave dhe periudhave të publikuara në faqet e internetit: www.pa.edu.tr dhe www.isga.edu.tr, dhe që aplikojnë personalisht, dhe që e kalojnë me sukses intervistën, do të pranohen në programin e doktoraturës, të ofruar nga institutet e lidhura me Akademinë Kombëtare të



Policisë/Xhandarmërinë dhe Akademinë e Rojeve Bregdetare të Turqisë.

2. Programe arsimore

Këto janë arsimime të miratuara nga njësitë arsimore përkatëse të zbatimit të ligjit, të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Turqisë dhe të kryera në kuadër të çështjeve të përcaktuara në nenin 6.

Neni 5

Procedurat e bashkëpunimit

Palët mund të bashkëpunojnë për të shkëmbyer përvojat e tyre të fituara me anë të mobilitetit të ekspertëve për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve dhe programeve arsimore të ndryshme të fushave që mbulojnë institucionet zbatuese të këtij memorandumi mirëkuptimi.

Palët do të bashkëpunojnë në kryerjen e aktiviteteve arsimore, brenda kuadrit të çështjeve të detajuara në nenin 4.

a) Pala Pritëse do të sigurojë dhe përgatisë vendin e arsimimit, materialet e nevojshme arsimore dhe pajisje të tjera.

b) Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të përmirësohet nëpërmjet vizitave të ndërsjella në të gjitha nivelet.

c) Në këtë drejtim, ata mund të kryejnë vizita të përbashkëta të personelit dhe të trajnerëve, shkëmbimin e informacionit lidhur me çështje teknike dhe të kërkimit shkencor, mund të zhvillojnë programe dhe projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore, si dhe mund të organizojnë konferenca, seminare dhe simpoziume të përbashkëta për të përfituar nga zhvillimet shkencore, në përputhje me legjislacionin në fuqi të palëve.

Neni 6

Ekzekutimi i aktiviteteve arsimore

a) Palët, nëse kërkohet, për qëllimin e përcaktimit të programeve arsimore, do të sigurojnë që të kryhet një studim i “analizës së nevojave për arsimim” dhe që programet arsimore të organizuara bashkërisht të planifikohen si rezultat i këtij studimi analizues.

b) Palët do të ofrojnë shërbime të ndërsjella të arsimimit dhe trajnimit për praktikantët në institucionet arsimore dhe trajnuese, në kuadër të

këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe sipas një plani vjetor zbatimi që do të bëhet me korrespondencë.

c) Palët mund të caktojnë në mënyrë të ndërsjellë praktikantin dhe trajnerin sipas kualifikimeve dhe numrave të specifikuar në planin vjetor të zbatimit dhe programet arsimore mund të organizohen në të dyja shtetet.

d) Praktikanti dhe trajnerët do të kenë kualifikime, në përputhje me qëllimin dhe objektin e trajnimit.

e) Është thelbësore që Palët të bëjnë planet për kurset 1 vit paraprakisht. Megjithatë, Palët, kur kërkohet, mund të dërgojnë kërkesat e tyre në lidhje me kurset e kërkuara brenda një kohe të arsyeshme përpara fillimit të kursit.

f) Në planin vjetor të zbatimit që Palët do të dërgojnë, Palët do të specifikojnë çështjet teknike, siç janë llojet e kurseve, numri i pjesëmarrësve që do të pranohen, kualifikimet e praktikantit, shkollat ku zhvillohen kurset, emrat dhe adresat e njësive dhe qendrave arsimore, kohëzgjatja e kursit, nëse ka, arsimimi gjuhësor përpara fillimit të kursit dhe trajnimi në punë pas kursit, kushti i marrjes së një raportit mjekësor për kursin, statusi dhe grada e personelit që do të ndjekë kursin dhe tarifat e arsimimit.

g) Palët do të përmbushin kërkesat fizike të programit arsimor (vendi, pajisjet, materiali, klasa, biblioteka, laborator etj.), në përputhje me përmbajtjen e arsimimit, nevojat dhe pritshmëritë.

h) Programet arsimore do të monitorohen, vlerësohen dhe përmirësohen vazhdimisht gjatë zbatimit.

i) Pala Pritëse do t'i sigurojë praktikantit materialet që përdoren për arsimimin, të specifikuara në programin arsimor dhe në fund të programit të arsimimit praktikanti do të kthejë materialet ndihmëse.

j) Diploma, dokumenti i kursit ose certifikata që do t'i jepet praktikantit në përfundim të arsimimit dhe trajnimit do të lëshohen nga autoritetet kompetente të Palës që ofron arsimimin dhe do t'u jepet praktikantëve në ceremoninë e diplomimit. Në rast të mos plotësimit të dështimit, do të lëshohet një dokument që tregon dështimin.

k) Praktikanti duhet të sjellë edhe uniformat e arsimimit dhe ceremonisë që do të kërkohen gjatë arsimimit dhe trajnimit.



l) Para fillimit të arsimimit, informacioni për programin e kursit, standardet dhe legjislacionin disiplinor do të bëhet nga qendra përkatëse e kurseve.

m) Autoritetet kompetente të Palës Dërguese do të njoftohen për personelin që konsiderohet i papërshtatshëm për vazhdimin e arsimit dhe trajnimit për shkak të dështimit, mosdisiplinës dhe papërshtatshmërisë sanitare brenda kuadrit të legjislacionit dhe parimeve të Palës Pritëse. Në vijim të njoftimit, do të zbatohet procesi i largimit nga arsimimi dhe i ndërprerjes së arsimimit dhe trajnimit. Nëse kushtet për periudhën e arsimimit janë të përshtatshme, një student i ri mund të pranohet për të zëvendësuar personelin e dërguar në vendin e tij. Personeli që i është nënshtruar largimit nga arsimimi dhe përfundimit të arsimimit dhe trajnimit nuk do të dërgohet më për qëllime arsimimi dhe trajnimi.

n) Meqenëse gjuha e arsimimit është gjuha turke në një trajnim për eprorë të nivelit të parë dhe një arsimim master pa teza, të organizuara në Qendrën e Trajnimit për Eprorë të Policisë të lidhur me Akademinë Kombëtare të Policisë Turke, si dhe një Trajnim Bazë për Oficer dhe një Trajnim Bazë për Nënoficer dhe programet e masterit dhe doktoraturës, të organizuara në Xhandarmërinë dhe Akademinë e Gardës Bregdetare të Turqisë, si dhe kurset e formimit teknik profesional të ofruara nga Xhandarmëria Turke, studentët e pranuar do t'i nënshtrohen fillimisht provimit të nivelit të gjuhës turke. Mësimi në gjuhën turke organizohet mesatarisht 1 (një) vit për studentët që nuk e marrin provimin. Më pas, studentët që rezultojnë të suksesshëm në arsimim përfshihen në arsimimin në fjalë. Trajnimet dhe kurset e tjera arsimore do të zhvillohen kryesisht në gjuhën e shtetit pranues ose në gjuhën angleze. Pala Dërguese mund të kërkojë një numër të mjaftueshëm përkthyesish për programin e arsimimit. Pala Dërguese përcakton kërkesën dhe kostot (shpenzimet) e saj në lidhje me përkthyesit me marrëveshje të ndërsjellë me Palën Pritëse të paktën 3 (tre) muaj përpara fillimit të trajnimit.

Neni 7

Çështjet e disiplinës dhe përfundimi i trajnimit

1. Staf i ftuar/kandidatët/të trajnuarit duhet të jenë të detyruar t'u binden të gjitha rregullave dhe udhëzimeve aktuale të njësisë dhe institucioneve të Palës Pritëse. Personeli/ kandidati/trajnuesi që shkel këto rregulla dhe udhëzime përjashtohet nga zhvillimi i aktiviteteve të tij dhe kthehet në vendin dërgues.

2. Pala Pritëse ka të drejtë të ndërpresë trajnimin e personave që pranohen në trajnim sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi në rastet e mëposhtme:

a) paafësi akademike (nuk arrin të marrë rezultatet e kërkuara);

b) shkelje e legjislacionit të vendit të vendosur ose e rregullave disiplinore të institucionit ku trajnohen;

c) përcaktimi i situatës që krijohet gjatë periudhës së arsimimit dhe mund të shkaktojë probleme shëndetësore gjatë vazhimit të arsimimit.

3. Ndërprerja dhe largimi të zbatohen sipas parimeve të mëposhtme:

a) largimet do të jepen në përputhje me orarin e punës të Palës Pritëse dhe me parimet e zbatueshme për homologët e Palës Pritëse;

b) largimet brenda vendit të Palës Pritëse do të bëhen nga drejtuesi i njësisë, institucionit dhe objektit ku trajnohet praktikanti, nëse konsiderohet e përshtatshme nga autoriteti kompetent i Palës Dërguese;

c) largimet jashtë vendit të Palës Pritëse do të jepen nga autoritetet kompetente të Palës Dërguese, në përputhje me marrëveshjen që do të arrihet nga autoritetet kompetente të të dy vendeve;

d) zbatimi i pushimit dhe i raporteve mjekësore të praktikantëve deri në 20 ditë vendoset nga drejtuesi i njësisë, institucionit dhe objektit ku ata trajnohen, në përputhje me parimet e Palës Pritëse, dhe në rast se duan të kalojnë më shumë se 20 ditë pushimi, dhe raporte jashtë Palës Pritëse do të vendoset nga autoriteti kompetent i Palës Pritëse, nëse autoriteti kompetent i Palës Dërguese e çmon të përshtatshëm;

e) në rast të vdekjes së praktikantit ose të afërmeve të tij/saj, Pala Pritëse do të informojë Palën Dërguese për vdekjen, do ta transferojë



trupin e të ndjerit në aeroportin më të afërt dhe do të marrë masat e nevojshme sanitare.

4. Çështjet lidhur me kërkesat për kompensim do të zgjidhen si më poshtë:

a) gjatë zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, legjislacioni kombëtar i Palës Pritëse do të zbatohet për pretendimet e kompensimit të palës së tretë;

b) përveç rasteve kur ka një neglizhencë ose qëllim të rëndë, Palët nuk mund të kërkojnë kompensim nga njëra-tjetra në rast të lëndimit ose vdekjes së stafit të tyre ose për dëmtimin e personit, pronës dhe mjedisit gjatë ekzekutimit të aktiviteteve sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi;

c) Palët përcaktojnë bashkërisht nëse situata është shkaktuar nga pakujdesia apo qëllimi i rëndë.

Neni 8

Caktimi i trajnerëve për trajnime në terren

a) Në rast të marrëveshjes mbi lëndët e arsimimit, kohën dhe kohëzgjatjen e arsimimit, trajneri caktohet në Palën Pritëse për trajnime në terren dhe do të vendoset nga autoriteti kompetent i Palës Dërguese.

b) Autoriteti kompetent i Palës Dërguese do të sigurojë që personeli, i cili do të caktohet për trajnimin në terren, përbëhet nga njerëz që janë ekspertë në fushat e tyre.

c) Trajnerët e caktuar për trajnimin në terren do të emërohen në institucionet e arsimit dhe trajnimit të Palës Pritëse.

d) Pala Pritëse do të njoftojë Palën Dërguese, nëpërmjet kanalit të duhur të bashkëpunimit, se cilat lëndë arsimore dhe për çfarë periudhe kanë nevojë për një trajner për trajnimin në terren. Numri i personelit që do të marrë pjesë në arsimimin e parashikuar nga Pala Pritëse, kualifikimet e personelit që merr pjesë në arsimim, emrat dhe vendndodhjet e shkollave, qendrave arsimore dhe njësive ku do të zhvillohet arsimimi, numri i ndihmëstrajnerëve dhe përkthyesve, nëse ka, lista e pajisjeve dhe materialeve në dispozicion për arsimimin do të specifikohen gjithashtu në këtë njoftim.

e) Pala Pritëse do të caktojë një automjet për personelin e trajnimit në terren nga aeroporti deri në përfundim të detyrës së tyre. Ky mjet do të përdoret për transferimin ndërmjet ambienteve të banimit, shkollave, qendrave arsimore dhe njësive.

f) Gjatë arsimimit, personeli i Palës Pritëse do të menaxhohet nga trajnerë të caktuar nga autoriteti kompetent i Palës Dërguese për trajnime në terren.

g) Gjatë planifikimit të trajnimit në terren do të merret si kriter që një grup prej 3 trajnerësh mund të trajnojë një grup prej rreth 40–50 personash.

h) Është thelbësore që grupi i synuar të jetë administrator në trajnimin në terren. Megjithatë, ekspertët e fushës së detyrës së tyre mund të konsiderohen si grupi i synuar për sa i përket temës, qëllimit ose fushës së trajnimit që do të organizohet.

i) Në trajnimet në terren, trajnimet do të zhvillohen në gjuhën zyrtare të trajnerit të Palës Dërguese. Për këtë qëllim, është thelbësore që Pala që merr trajnerët të sigurojë një numër të mjaftueshëm përkthyesish. Pala që dërgon trajnerin përcakton kërkesat dhe shpenzimet (kostot) e përkthyesit, me marrëveshje të ndërsjellë me palën që pranon trajnerin, të paktën tre muaj përpara fillimit të trajnimit.

j) “Certifikata e kursit” ose “Certifikata” do t’i jepet praktikantit të Palës Pritëse që mori pjesë dhe përfundoi me sukses trajnimin në terren, nga trajnerët e caktuar për trajnimin në terren nga Pala Dërguese.

Neni 9

Situatat e jashtëzakonshme dhe ndalimi i delegimit

a) Personeli nuk duhet të marrë pjesë kurrë në një konflikt të armatosur ose në aktivitete politike me një vend të tretë. Ai nuk do të ngarkohet me një detyrë sigurie të brendshme në Palën Pritëse dhe personelit të caktuar për arsimimin dhe trajnimin nuk do t’i jepet asnjë detyrë tjetër përveç detyrave të përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

b) Pala Dërguese mund të revokojë personelin e saj në çdo kohë dhe pa dhënë një arsye. Në këtë rast, Pala Pritëse do të marrë masat e nevojshme që procesi i revokimit të trajtohet sa më shpejt të jetë e mundur.

c) Në rast lufte, konflikti të armatosur, shqetësimi publik ose krize ndërkombëtare në njërën nga Palët, Pala Pritëse do ta kthejë personelin në vendin e saj, me kërkesë të Palës Dërguese.



d) Personeli i Palës Dërguese i nënshtrohet legjislacionit dhe juridiksionit të Palës Pritëse. Në rastet kur zbatohet juridiksioni i Palës Pritëse dhe kur përmbajtja e dispozitës parashikon një procedurë dënimi/ekzekutimi, e cila nuk është përcaktuar në legjislacionin e Palës dërguese, do të zbatohet një dënim që përfshihet në legjislacionin e të dyjave palëve.

Neni 10

Shërbimet sociale

Praktikantët, brenda fushës së statusit që kanë homologët e tyre në Palën Pritëse, do të përfitojnë shërbime sociale dhe administrative, të tilla si ambiente sociale, mensa, meny me çmim fiks dhe vende pune, në përputhje me legjislacionin aktual.

Neni 11

Autoritetet koordinuese

Autoritetet e mëposhtme që do të kenë të drejtë të sigurojnë koordinim për zbatimin e këtij Memorandum Mirëkuptimi:

- a) Për Palën e Shqipërisë: Ministria e Brendshme;
- b) Për Palën e Turqisë: Ministria e Brendshme.

Neni 12

Çështjet financiare

a) Shteti pritës do të vendosë të ofrojë trajnime për personelin, i cili merr trajnim, me pagesë, pa pagesë ose me zbritje. Në rast trajnimi falas, ai do të jetë në gjendje të mbulojë shpenzimet e mëposhtme:

1. Për studentët:
 - i. ushqimin;
 - ii. akomodimin;
 - iii. dietat (rregullat dhe shuma do të përcaktohen nga shteti pritës);
 - iv. shpenzimet e trajnimit-arsimimit;
 - v. veshjet (ekuivalente me dietat e shtetit pritës të përcaktuara për studentët e tij);
2. Për personelin praktikant që do të marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Komanda e Përgjithshme e Xhandarmërisë dhe Komanda e Rojës Bregdetare:
 - i. pagat mujore (rregullat dhe shuma përcaktohen nga shteti pritës);

- ii. shpenzimet e trajnimit-arsimimit;
- iii. veshjet (ekuivalente me kompensimet e shtetit pritës të përcaktuara për studentët e tij);

- iv. ushqimin;
- v. akomodimin;
- vi. transportin e brendshëm;

3. Për personelin praktikant që do të marrë pjesë në trajnimet dhe arsimimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë:

- i. ushqimin;
- ii. akomodimin;
- iii. shpenzimet e trajnimit-arsimimit.

b) Përveçse kur bihet dakord ndryshe, shpenzimet e transportit ndërkombëtar do të mbulohen nga Pala Dërguese.

c) Nëse vendoset që arsimimi të sigurohet me tarifë, shpenzimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni do të paguhet në dollarë amerikanë, në numrat e llogarisë të njoftuara nga shteti personeli i të cilit është trajnuar, brenda 30 ditëve nga përfundimi i periudhës ose veprimtarisë së arsimimit.

d) Personeli i ftuar do t'i nënshtrohet legjislacionit aktual doganor, tatimor dhe tregtar të shtetit pritës gjatë periudhës së hyrjes, qëndrimit dhe daljes së tij.

e) Personeli i ftuar është i detyruar të likuidojë detyrimet personale dhe familjare, në momentin që largohet nga shteti pritës për çfarëdo arsye. Shteti dërgues do të marrë masat e nevojshme për detyrimet personale të cilat personeli i ftuar nuk i ka likuiduar.

f) Në rast se trajnerët caktohen për trajnim në terren:

1. Pala Pritëse do të mbulojë shpenzimet e transportit të pajisjeve dhe materialeve të cilat Pala Dërguese i dërgon te Pala Pritëse për trajnimin në terren;

2. Shpenzimet e transportit dhe pagat ditore të personelit, për zbatimin e ligjit të Palës Dërguese, do të mbulohen nga Pala Dërguese, ndërsa shpenzimet për ushqimin dhe akomodimin do të mbulohen nga Pala Pritëse. Pala Pritëse do të paraqesë vendin për akomodimin dhe ushqimin e trajnerëve të caktuar për trajnimin në terren, dhe do të sigurojë të gjitha llojet e lehtësirave.



Neni 13

Shërbimet shëndetësore

a) Në përputhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi, personeli praktikant i zbatimit të ligjit duhet të jetë në kushte shëndetësore të tilla që mund të kryejë të gjitha llojet e aktiviteteve. Pala Pritëse mund t'i kërkojë një raport mjekësor ku të specifikohet se këta persona janë të përshtatshëm për sa i përket shëndetit.

b) Shpenzimet e shërbimit të ekzaminimit dhe trajtimit të studentit, praktikantit dhe personelit të zbatimit të ligjit do të mbulohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Pritëse. Primet e sigurimit shëndetësor ose shpenzimet shëndetësore të studentit do të mbulohen nga Pala Pritëse. Primet e sigurimit shëndetësor ose shpenzimet shëndetësore të personelit praktikant të zbatimit të ligjit do të mbulohen nga Pala Dërguese.

c) Shërbimet urgjente shëndetësore dhe shërbimet urgjente të kujdesit dentar të personelit, përveç praktikantëve dhe studentëve, do të sigurohen pa pagesë nga Pala Pritëse. Shpenzimet e shërbimeve të ekzaminimit dhe trajtimit, përveç shërbimeve urgjente shëndetësore dhe të kujdesit urgjent dentar, do të mbulohen nga Pala Dërguese.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mospajtimet dhe mosmarrëveshjet, që lindin nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi, do të zgjidhen nëpërmjet negociatave ose konsultimeve ndërmjet Palëve.

Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe teksteve ligjore ndërkombëtare të lidhura më parë ndërmjet Palëve, dispozitat e këtij Memorandumi do të kenë përparësi.

Neni 15

Ndryshimet

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet në çdo kohë, me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë ligjore të parashikuar në nenin 16, të këtij Memorandumi.

Neni 16

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilës Palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave ligjore të parashikuara në legjislacionin e tyre kombëtar për hyrjen e tij në fuqi.

Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet për një periudhë 1 (një)-vjeçare. Përveç nëse një nga palët kontraktuese njofton me shkrim palën tjetër, për qëllimin e saj, për të përfunduar këtë Memorandum Mirëkuptimi në rrugë diplomatike, 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të tij, do të rinovohet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme prej 1 (një) viti. Ky Memorandum Mirëkuptimi përfundon gjashtë muaj pas njoftimit të përfundimit.

Përfundimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk ndikon përjashtimisht në programet arsimore të nisura ose në vazhdim, përveç rasteve kur ka ndonjë rregullim që rrjedh nga legjislacioni vendas.

Nënshkruar në Tiranë, më 17.1.2022, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bledar Çuçi
Ministër i Brendshëm

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
TURQISË

Süleyman Soylu
Ministër i Brendshëm



VENDIM
Nr. 151, datë 11.3.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE TË APLIKIMIT,
TË RREGULLAVE TË KRYERJES SË
VERIFIKIMEVE DHE KONTROLLEVE
TË NEVOJSHME PËR FITIMIN E
SHTETËSISË SHQIPTARE PËR
KONTRIBUT TË VEÇANTË NË
FUSHËN E ARTIT E TË KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I
PËRKUFIZIME**

1. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Program i veçantë i shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës”**, tërësia e dispozitave normative, e kriterëve teknike, kulturore dhe artistike, mbi bazën e të cilave një kontribut i një shtetasi të huaj do të vlerësohet si kontribut me interes në fushën e artit e të kulturës për shtetin shqiptar dhe me anë të cilit mund të fitohet shtetësia shqiptare.

b) **“Kontribut me interes në fushën e artit”**, veprimtaria krijuese artistike e çdo fushe e disipline të artit, me ndikim të spikatur në vendin e origjinës dhe për Republikën e Shqipërisë.

c) **“Kontribut me interes në fushën e kulturës”**, veprimtaria krijuese kulturore e çdo fushe e disipline kulturore, me ndikim të spikatur në vendin e origjinës dhe për Republikën e Shqipërisë.

ç) **“Kërkesë për fitimin e shtetësisë shqiptare”**, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi për fitimin e shtetësisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi me prokurë, në bazë të formularëve të miratuar.

d) **“Kërkues”**, çdo shtetas i huaj, i cili plotëson kriteret teknike dhe aplikon për fitimin e shtetësisë

shqiptare, sipas programeve të veçanta në fushën e artit e të kulturës.

dh) **“Vlerësim kontributi”**, akti me anë të të cilit ministria përgjegjëse përcakton kontributin e kërkuesit në fushën e artit e të kulturës, për t’u bërë pjesë e programeve të veçanta të shtetësisë.

**KREU II
KRITERET PËR APLIKIM**

1. Ka të drejtë të kërkojë për t’u përfshirë në programin e veçantë shtetasi i huaj (në vijim “kërkuesi”), që plotëson këto kriterë:

a) ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;

b) ka zotësi për të vepruar;

c) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në shtetin e vet, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie. Përfshirja nga kjo rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike;

ç) nuk përbën kërcënim për sigurinë kombëtare dhe rendin publik të Republikës së Shqipërisë;

d) nuk figuron i regjistruar si person me rekorde kriminale në listat e organizatave ndërkombëtare, partnere të sigurisë;

dh) deklaron se do të banojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të paktën 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) vjetëve nga aprovimi i kërkesës;

e) disponon të ardhura dhe burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë;

ë) provon kontributin e veçantë në fushën e artit e të kulturës, si dhe arritjet e veçanta të tij pranë ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën;

f) dëshmon arritjen e rezultateve të larta ndërkombëtare në fushën e artit e të kulturës, sipas disiplinës përkatëse që përfaqëson pranë ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën;

g) nuk është subjekt i masave shtrënguese ndërkombëtare të pranuar nga Republika e Shqipërisë.



KREU III

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR
FORMËN DHE PARAQITJEN E KËRKESËS
PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare do të bëhet në bazë të formularëve të kërkesës së miratuar nga Agjencia për Hartimin e Programeve të Veçanta të Shtetësisë (në vijim “AHPVSH”).

2. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer me vërtetim noteri.

3. Kërkesa për përfshirjen në programin e veçantë të shtetësisë paraqitet në AHPVSH në formë elektronike ose nëpërmjet postës nga vetë kërkuuesi ose përfaqësuesi me prokurë.

4. Në çdo rast, kërkesat për fitimin e shtetësisë shqiptare të paraqitura prej përfaqësuesit me prokurë në emër të kërkuarit duhet të nënshkruhen nga vetë kërkuuesi në emër të të cilit paraqitet kërkesa.

5. Në rast se rezulton që kërkesa për fitimin e shtetësisë nuk është nënshkruar nga vetë kërkuuesi, kjo përbën shkak për mospranimin e saj.

6. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare duhet të përmbajë:

a) emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuarit;

b) tregimin e fakteve dhe të rrethanave që mbështesin kërkimin për fitimin e shtetësisë.

KREU IV

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR
PARAQITJEN E KËRKESËS PËR SHTETËSI

1. Për të provuar plotësimin e kritereve, duhen këto dokumente:

a) kërkesë individuale për fitimin e shtetësisë shqiptare drejtuar AHPVSH-së, nënshkruar personalisht nga kërkuuesi, sipas formularit të miratuar të kërkesës;

b) kopje të dokumentit të identifikimit;

c) certifikatë personale e kërkuarit;

ç) certifikatë familjare e kërkuarit;

d) 3 (tri) fotografi, format dokumenti, të cilat duhet të jenë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, të marrë në plan me sfond të bardhë, të fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm.

dh) certifikatë e gjendjes gjyqësore, e lëshuar sipas legjislacionit në fuqi, e marrë në vendin e origjinës, në vendin ku kërkuuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm për 6 (gjashtë) muajt e fundit, në shtetet e treta, ku ka jetuar jo më pak se 6 (gjashtë) muaj, brenda 3 (tri) vjetëve të fundit;

e) dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: garanci bankare, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noterizuar);

ë) deklaratë se do të banojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të paktën 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) vjetëve nga aprovimi i kërkesës;

f) dëshmi për shërbimin e jashtëzakonshëm (të veçantë) që kërkuuesi sjell për Republikën e Shqipërisë ose popullin shqiptar, ose nëse kërkuuesi pretendon se marrja e shtetësisë nga ai përbën një interes të veçantë për Republikën e Shqipërisë, e vërtetuar nga autoritetet kompetente, shoqëruar me kopje të çmimeve, vlerësimeve, titujve të ndryshëm ose çdo dokument tjetër të lëshuar nga institucionet e vendit të origjinës dhe/ose ato shqiptare, i cili provon fitimin e titujve të nderit, çmimeve apo vlerësimeve të marra nga kërkuuesi;

g) rekomandim të lëshuar nga autoritetet kompetente për merita dhe arritje të veçanta në fushën e artit e të kulturës, sipas disiplinës përkatëse, si më poshtë vijon:

i. 1 (një) rekomandim nga ministria përgjegjëse për artin e kulturën, e vendit të origjinës;

ii. 1 (një) rekomandim nga një institucion qendror i artit e kulturës, i vendit të origjinës;

iii. 2 (dy) rekomandime nga personalitete të shquara të artit e të kulturës, të vendit të origjinës dhe/ose të shtetit shqiptar, të spikatur në gjininë apo disiplinën që lëvtron individit, i cili kërkon të fitojë shtetësinë shqiptare;

gj) deklaratë se informacionet e dhëna prej tij janë të vërteta dhe të sakta, sipas formularit të kërkesës së miratuar nga AHPVSH-ja;

h) çdo dokument tjetër provues, që vërteton plotësimin e kritereve të parashikuara në pikën 1, të kreut II të këtij vendimi.

2. Dokumentacioni, që i bashkëlidhet kërkesës për shtetësi shqiptare, duhet të jetë origjinal ose kopje e njësuar me origjinalin për ato dokumente, për të cilat procedura e lejon një formë të tillë.

3. Dokumentet origjinale ose, sipas rastit, kopjet e njësuara të tyre, lëshuar nga organet shtetërore të



vendit të origjinës së kërkesës, duhet të shoqërohen nga vula apostile ose, sipas rastit, nga legalizimi i tyre, bërë nga organet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Dokumentacioni bashkëlidhur aplikimit/kërkesës për shtetësi duhet të jetë lëshuar brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, afat vlefshmërie ky i përllogaritur nga dita e regjistrimit të kërkesës pranë AHPVSH-së.

5. Kërkesat për shtetësi pranohen e përpunohen me kusht që të jenë paraqitur sipas formës së kërkuar, të përmbajnë gjenealogjetet dhe nënshkrimin e kërkesës, si dhe shoqërohen me dokumentet e nevojshme e mandatpagesën, sipas tarifave të miratuara.

KREU V PROCESI I VERIFIKIMIT DHE I VLERËSIMIT TË KËRKESAVE PËR SHTETËSI

1. Pas depozitimit të kërkesës dhe dokumentacionit, AHPVSH-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve bën verifikimin paraprak për plotësimin e kushteve formale të parashikuara në kreun III të këtij vendimi.

2. Në rast se kërkesa nuk plotëson kushtet e kërkuara formale, AHPVSH-ja ia kthen atë kërkesës për plotësimin e të metave brenda një afati jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

3. Pasi AHPVSH-ja verifikon paraprakisht se kërkesa i përmbush të gjitha kushtet formale për paraqitjen e saj, kryen veprimet, si më poshtë vijon:

a) verifikon nëse kërkesi plotëson kërkesat teknike, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit të paraqitur;

b) kryen verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore dhe të sigurisë kombëtare në mënyrë zyrtare, nëpërmjet Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

c) i kërkon në mënyrë shkresore ministrisë përgjegjëse për artin e kulturën të vlerësojë kontributin e kërkesës në fushën e artit dhe të kulturës, sipas disiplinës që përfaqëson, duke i bashkëlidhur kopje të dëshmive dhe akteve të tjera vërtetuese të arritjeve të depozituara nga kërkesi, dhe i kërkon që, brenda 7 (shtatë) ditëve nga kërkesa për vlerësim kontributi, t'i përcjellë AHPVSH-së në mënyrë zyrtare shkresore

vendimin e arsyetuar me të cilin vlerëson se kontributi i kërkesës përbën interes për shtetin shqiptar.

4. Në rast se ministria përgjegjëse për artin e kulturën vlerëson se kontributi i kërkesës nuk përbën interes në fushën e artit dhe të kulturës për Republikën e Shqipërisë e popullin shqiptar, AHPVSH-ja përgatit një relacion informues drejtuar ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike për mosplotësimin e kriterëve teknike nga kërkesi.

4.1 Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, pas vlerësimit të relacionit dhe konstatimit të mosplotësimit të kriterëve teknike, merr vendim për refuzimin e kërkesës për fitimin e shtetësisë.

4.2 AHPVSH-ja njofton kërkesin në adresën e deklaruar në formularin e aplikimit për vendimin e refuzimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare.

5. Në rast se ministria përgjegjëse për artin e kulturën vlerëson se kontributi i shtetasit të huaj përbën interes të veçantë për Republikën e Shqipërisë dhe popullin shqiptar, AHPVSH-ja vazhdon me procesin e shqyrtimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare.

6. AHPVSH-ja, pasi shqyrton kërkesën lidhur me përputhshmërinë e kriterëve teknike për fitimin e shtetësisë, vlefshmërinë dhe formën e rregullt ligjore të dokumentacionit, merr konfirmimet zyrtare të verifikimeve të sigurisë dhe të pastërtisë së figurës nga autoritetet kompetente, si dhe vlerësimin pozitiv të kontributit të kërkesës nga ana e ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën, përgatit një relacion drejtuar ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike për plotësimin e kushteve të miratuara nga ana e kërkesës.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministri përgjegjës për artin e kulturën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



VENDIM
Nr. 152, datë 11.3.2022

**PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN,
FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E
SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË
KËSHILLIT TË METROLOGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Metrologjisë (në vijim, KM) si një organ këshillimor që ngrihet e funksionon pranë drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (në vijim, DPM), me qëllim këshillimin për përcaktimin e prioritetëve të zhvillimit të metrologjisë, zhvillimin e ruajtjen e politikave kryesore, të strategjive dhe parimeve funksionale të DPM-së, si dhe sigurimin e ruajtjen e paanshmërisë së saj.

2. KM-ja është një organ i përhershëm i strukturës së DPM-së, i cili ka në përbërje të tij përfaqësues të institucioneve.

3. Anëtarët e KM-së shpërblehen për çdo mbledhje, në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë, nga fondet e akorduara për shpenzime korente në vitin buxhetor përkatës.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË KËSHILLIT TË METROLOGJISË

KM-ja ka përgjegjësi që të sigurojë:

a) dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e metrologjisë shkencore, industriale dhe ligjore, si dhe të infrastrukturës së përgjithshme kombëtare të metrologjisë;

b) të japë rekomandime për zhvillimin e aktiviteteve kombëtare të kalibrimin të instrumenteve matëse, të etaloneve kombëtare të njësive të matjes, si dhe të materialeve referuese;

c) të shqyrtojë e të japë mendime për projektpropozime në fushën e metrologjisë me financime nga programet kombëtare ose ndërkombëtare;

ç) të promovojë dhe të zhvillojë bashkëpunimin ndërsektorial e ndërdisiplinar në fushën e metrologjisë;

d) të japë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit për metrologjinë dhe çështje të tjera lidhur me problemet teknike e organizative;

dh) të adresojë çështjet e ngritura nga institucionet qeveritare brenda kompetencave të KM-së;

e) të japë rekomandime për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës, duke iu përgjigjur në kohë dhe cilësi kërkesave për progres;

ë) të japë rekomandime për përcaktimin e rishikimin e mundësive për realizimin e vizionit të DPM-së.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË METROLOGJISË

1. KM-ja është një organ këshillimor i drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

2. Numri i anëtarëve të KM-së është 13 (trembëdhjetë). KM-ja përbëhet nga përfaqësues, si më poshtë vijon:

a) drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, kryetar;

b) një përfaqësues nga Ministria e Financave dhe të Ekonomisë, përgjegjës për infrastrukturën e cilësisë, anëtar;

c) një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;

ç) një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, anëtar;

d) një përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtar;

dh) një përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtar;

e) një përfaqësues nga Konfederata e Industrive të Shqipërisë, anëtar;

ë) një përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, anëtar;

f) një përfaqësues nga Universiteti Politeknik i Tiranës, anëtar;

g) një përfaqësues i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, anëtar;

gj) një përfaqësues i Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit, anëtar;

h) një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, anëtar;

i) një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, anëtar.



3. Ministri përgjegjës për metrologjinë cakton anëtarët e KM-së me një mandat 3-vjeçar. Pas mbarimit të mandatit, anëtari ka të drejtën e rizgjedhjes.

3.1 Çdo entitet/institucion ka të drejtë të zëvendësojë përfaqësuesin e tij gjatë kohëzgjatjes së mandatit. Përfaqësuesi zëvendësues qëndron deri në fund të periudhës së mandatit trevjeçar, duke u rikonfirmuar në fund të tij. Zëvendësimi bëhet me të njëjtën procedurë të konfirmimit të anëtarëve të KM-së bazuar në kriteret e specifikuar në pikën 4, të kreut III.

3.2 Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në dy mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm, konsiderohet se ka hequr dorë si anëtar i KM-së. Në këtë rast, kryetari njofton menjëherë organin e emërtesës për zëvendësimin e tij. Ky zëvendësim bëhet në të njëjtën procedurë të konfirmimit të anëtarëve të KM-së, bazuar në kriteret e specifikuar në pikën 4, të kreut III.

4. Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të KM-së janë, si më poshtë vijon:

a) të ketë përvojë pune të paktën 10 (dhjetë) vjet në sektorin që përfaqëson;

b) detyra që kryen të ketë lidhje me matjet apo me infrastrukturën e cilësisë;

c) të jetë detyrimisht në funksion drejtues ose të ketë titull shkencor në fushën e shkencave teknike ose në ato natyrore;

ç) të ketë njohje të përgjithshme të standardeve kryesore që aplikohen në fushën e metrologjisë, kryesisht ISO/IEC 17025, ISO/IEC 17020 dhe ISO/IEC 17043;

d) të njohë legjislacionin në fuqi për fushën e metrologjisë;

dh) të ketë aftësi të punojë në grup;

e) të ketë aftësi të mira komunikimi;

ë) të jetë i/e interesuar për zhvillimin e metrologjisë në Shqipëri.

5. Mbledhjet e KM-së thërren nga kryetari i KM-së ose me kërkesën me shkrim nga së paku 50 (pesëdhjetë) % e anëtarëve. Mbledhja e KM-së është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 50 (pesëdhjetë) % + 1 (një) të anëtarëve. KM-ja mblidhet të paktën dy herë në vit (muajin e parë të gjashtëmuajorit).

5.1 Anëtarët e këshillit janë të detyruar të njoftojnë lidhur me pjesëmarrjen apo mospjesëmarrjen e tyre 48 (dyzet e tetë) orë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Kur në mbledhje

nuk janë të pranishëm anëtarët e nevojshëm për kuorumin e mbledhjes, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të afërt.

5.2 Për të prezantuar, analizuar apo diskutuar çështje specifike, mund të thërren apo të ftohen punonjës të DPM-së me kërkesë të kryetarit të KM-së.

6. Kryetari i KM-së ka këto funksione:

a) drejton të gjitha mbledhjet e KM-së;

b) koordinon me sekretariatën për agjendën e mbledhjeve të KM-së;

c) administron materialet e nevojshme, të cilat kërkohen nga anëtarët e tjerë;

ç) prezanton një raport mbi aktivitetin dhe planin e DPM-së në mbledhjen e parë të çdo viti;

d) informon KM-në lidhur me statusin e përfaqësimit në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të metrologjisë, si dhe për plotësimin e kërkesave dhe të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në to.

7. Kryetari i KM-së cakton një punonjës të DPM-së në detyrën e sekretarit, për një periudhë njëvjeçare. Sekretari i KM-së u dërgon pjesëmarrësve, zyrtarisht dhe në rrugë elektronike, rendin e ditës së mbledhjes dhe materialet e nevojshme, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para takimit.

7.1 Në rastin e materialeve voluminoze, ato u ofrohen anëtarëve në zyrën e sekretariatit ose dërgohen në rrugë elektronike.

7.2 Dokumentimi i të gjithë veprimtarisë së KM-së gjatë mbledhjes pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga sekretari, nën drejtimin e kryetarit. Procesverbali i mbledhjes u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit.

7.3 Mbledhjet e KM-së dokumentohen edhe nëpërmjet regjistrimit audio. Një kopje e procesverbalit të mbledhjes, regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është e mundur, dhe të çdo materiali tjetër të administruar gjatë zhvillimit të saj depozitohen në arkivin e DPM-së.

8. Rekomandimet e sugjeruara nga KM-ja miratohen me shumicë të thjeshtë votash nga anëtarët e pranishëm.

9. Raporti vjetor i punës së KM-së është pjesë e raportimit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të



Metrologjisë në ministrinë përgjegjëse për metrologjinë.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Urdhri nr. 517, datë 7.7.2008, i ministrit të Ekonomisë, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Metrologjisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 153, datë 11.3.2022

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 656, DATË 31.10.2018, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E MASËS SË
SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË
KËSHILLAVE, BORDEVE OSE
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për shpërblimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi fillojnë nga data 1 janar 2021 dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

TABELA

Emërtesa e Bordit/Këshillit/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në lekë	
		Kryetari	Nr. i anëtarëve	Kryetari	Anëtari
Këshilli i Emërimeve në Drejtësi	12	1	8	50,000	50,000
Komisioni për Licencimin e Ndërmjetësve	12	1	4	5,000	5,000
Komisioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale	12	1	8	20,000	20,000
Komisionet e posaçme për provimin e kualifikimit për përkthyes zyrtarë të gjuhës përkatëse	5	1	4	10,000	10,000
Komisioni i posaçëm për provimin e kualifikimit për interpret të gjuhës së shenjave	5	1	4	10,000	10,000
Komisioni Disiplinor për Përkthyes Zyrtarë	5	1	4	15,000	10,000
Komisioni Disiplinor për Interpret të Gjuhës së Shenjave	5	1	4	15,000	10,000
Komisioni për Prodhimin Biologjik	12	1	8	8,000	6,000
Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët	12	1	4	10,000	10,000

**VENDIM****Nr. 154, datë 11.3.2022**

**PËR NJË SHITESË NË NUMRIN E
PUNONJËSVE ORGANIKË NË NJËSITË
E QEVERISJES QENDRORE,
PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2022, shtohet me 42 (dyzet e dy) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 2 459 (dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë) veta.

2. Numri i punonjësve, për vitin 2022, për Agjencinë Kombëtare të Shqërisë së Informacionit shtohet me 12 (dymbëdhjetë) punonjës dhe për Komitetin e Pakicave Kombëtare shtohet me 4 (katër) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të institucioneve në varësi të Kryeministrit në 1 363 (një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) veta.

3. Numri i punonjësve të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2022, shtohet me 2 (dy) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 15 111 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) veta.

4. Numri rezervë i punonjësve, për vitin 2022, reduktohet me 60 (gjashtëdhjetë) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm rezervë në 40 (dyzet) veta.

5. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

VENDIM**Nr. 155, datë 11.3.2022**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
PËRGJITHSHME PËR PROCEDURAT E
DHËNIES TË SË DREJTËS SË KALIMIT
PËR NDËRTIMIN E RRJETEVE TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ME
SHPEJTËSI TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen organet e qeverisjes qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

**RREGULLAT E PËRGJITHSHME
PËR PROCEDURAT E DHËNIES TË SË
DREJTËS SË KALIMIT PËR
NDËRTIMIN E RRJETEVE TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ME
SHPEJTËSI TË LARTË**

**Neni 1
Objekti**

Ky vendim ka si objekt përcaktimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë në pronën publike.



Neni 2

Parime të përgjithshme

E drejta e kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë duhet t'u ofrohet sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, në kushte të barabarta, objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

E drejta e kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, për pronën e të tretëve, u jepet sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi, duke garantuar përdorimin e pronës, sipas standardeve dhe rregullave të shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Neni 3

Përkufizime

Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ato të ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet për të drejtën e kalimit

1. Dhënia e së drejtës së kalimit në pronën publike bëhet nga organi përkatës, sipas legjislacionit në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit.

2. E drejta e kalimit përfshin, por pa u kufizuar vetëm në të, të drejtën:

a) për të instaluar dhe mbajtur rrjetin e komunikimeve elektronike mbi tokë, nën tokë, mbi ujë apo nën ujë;

b) për të ndërtuar dhe mbajtur struktura mbështetëse të linjave, pajisje ndërtuese dhe objekte të tjera të linjës, si dhe aksesore shtesë;

c) për të vendosur linja kabllore në ndërtesa dhe struktura të tjera;

ç) për të vendosur në punë sistemet e listuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të kësaj pike;

d) për të hequr pemët, shkurret, degët e tyre dhe rrënjët e ndodhura brenda zonës së sigurisë së rrjeteve të komunikimeve elektronike, të cilat

cenojnë sigurinë e funksionimit të tyre, duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

3. Me përfundimin e së drejtës së kalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas lejes së ndërtimit, të miratuar në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit nga Këshilli Kombëtar i Territorit apo kryetari i bashkisë, sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike është i detyruar:

i. të kthejë pronën e përdorur në gjendjen e mëparshme në rastin e përfundimit të punimeve;

ii. të kthejë pronën në gjendjen e mëparshme në rastin e përfundimit të së drejtës së kalimit, në rast se është parashikuar në leje.

Neni 5

Rastet e kufizimit

E drejta e kalimit nuk ofrohet në rastet e parashikuara në ligj, kur ajo cenon sigurinë dhe integritetin e rrjetit dhe të pronës, sigurinë kombëtare dhe sigurinë e shëndetit publik. Në çdo rast, refuzimi i dhënies të së drejtës së kalimit duhet të dalë me vendim të arsyetuar.

Neni 6

Kërkesat për aplikim për të drejtë kalimi

1. Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, në momentin e aplikimit për lejen e së drejtës së kalimit pranë autoriteteve përgjegjëse duhet të depozitojë informacionin dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) gjenealogjetet e sipërmarrësit ose emrin e regjistruar dhe selinë e personit juridik, certifikatën e regjistrimit të aktivitetit, si dhe personat e kontaktit;

b) autorizimin e përgjithshëm, të lëshuar nga AKEP-i, për lejimin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;

c) përshkrimin e detajuar të rrjetit ose shërbimit të komunikimeve elektronike, duke përfshirë të gjitha përshkrimet dhe skemat teknike;

ç) të dhëna të plota për pronën, ku kërkohet të ushtrohet e drejta e kalimit, përfshirë edhe treguesit hartografikë/gjeografikë, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;



d) projektin e shoqëruar me një plan të detajuar të punëve që do të kryhen, ku përfshihen, veçanërisht, qëllimi, natyra dhe përshkrimi i punimeve të kërkuara, afatet për kryerjen e këtyre punimeve dhe dokumentet grafike, ku evidentohen ndërhyrjet e propozuara;

dh) afatet e parashikuara për realizimin e planit të punëve, të parashikuara në shkronjën “e”, të kësaj pike, dhe kohëzgjatjen e punimeve;

e) vërtetimin e disponimit të mjeteve të nevojshme financiare për përfundimin e veprimtarive të planifikuara, duke paraqitur një dokument/vërtetim bankar për disponimin e tyre;

ë) çdo dokument tjetër të nevojshëm, të përcaktuar paraprakisht dhe të njoftuar nga organi i qeverisjes vendore.

2. Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëshojë një deklaratë, duke përfshirë listën e plotë të pajisjeve me detajet teknike, ku të konfirmojë se çdo pajisje e komunikimeve elektronike e instaluar nën tokë do të jetë në përputhje me kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve të komunikimeve elektronike, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Lehtësimi i procedurës

1. Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike informohet nga autoritetet përgjegjëse për ekzistencën e rrjeteve ekzistuese të komunikimeve elektronike dhe të sipërmarrësve zotërues të këtyre rrjeteve, me qëllim shmangien e dëmtimeve në infrastrukturën e rrjeteve të tjera.

2. Aplikimi për lejen e së drejtës së kalimit bëhet sipas procedurave të parashikuara në këtë vendim.

Neni 8

Afatet për të drejtën e kalimit

1. Autoriteti përgjegjës për dhënien e së drejtës së kalimit shqyrton aplikimin dhe njofton aplikuesin, nëse ka nevojë për plotësim të dokumentacionit brenda afateve ligjore të përcaktuara.

2. Autoriteti përgjegjës për dhënien e së drejtës së kalimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, merr vendimin për

miratimin ose refuzimin e së drejtës së kalimit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga aplikimi i plotë.

3. Jetëgjatësia e së drejtës së kalimit, lëshuar nga autoriteti përgjegjës për dhënien e së drejtës së kalimit, mund të jetë deri në 20 (njëzet) vjet.

Neni 9

Vendimi për të drejtën e kalimit

1. Vendimi i autoritetit përgjegjës për miratimin e kërkesës duhet të përmbajë:

a) shprehimisht miratimin e kërkesës për përfitimin e së drejtës së kalimit dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi;

b) të dhënat e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike dhe llojin e veprimtarisë së tij;

c) treguesit gjeografikë/hartografikë të sipërfaqes, për të cilën do të ushtrohet e drejta e kalimit;

ç) mënyrën e ushtrimit të së drejtës së kalimit;

d) kushtet e përdorimit të përbashkët, nëse është e mundur.

2. Vendimi i autoritetit përgjegjës për refuzimin e kërkesës duhet të përmbajë:

a) shprehimisht refuzimin e kërkesës për përfitimin e së drejtës së kalimit dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi;

b) të dhënat e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike dhe llojin e veprimtarisë së tij.

3. Sipërmarrësi nuk mund të paraqesë kërkesë të re me të njëjtin objekt dhe shkak, nëse autoriteti përgjegjës ka vendosur më parë refuzimin e kërkesës, përveçse kur ndryshojnë rrethanat e marra në konsideratë në vendimarrjen e tij të parë, si dhe kur parashikohet ndryshe në ligj.

Neni 10

Ankimi në rast refuzimi

Kundër vendimit për refuzimin e së drejtës së kalimit, aplikuesi ka të drejtë të ankohet pranë gjykatës administrative kompetente në territorin e njësisë vendore përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Detyrimi për informim

Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, pas miratimit të lejes së kalimit dhe pas ndërtimit të rrjetit komunikimeve elektronike me



shpejtësi të lartë, duhet të depozitohet pranë autoritetit përgjegjës dhe AKEP-it planimetritin e rrjetit të ndërtuar.

Neni 12

Kërkesat për ndryshime

Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike ka të drejtë të kërkojë modifikimin, rinovimin ose revokimin e lejes të së drejtës së kalimit, sipas rregullave të miratuara nga autoritetet përgjegjëse.

Neni 13

Garantimi i transparencës

Autoritetet përgjegjëse publikojnë rregullat për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit në faqen zyrtare të internetit dhe/ose në mjediset e ofrimit të shërbimeve.

Rregullat e dhënies të së drejtës së kalimit nga autoriteti përkatës sipas pikës 1, të nenit 4, duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme, të qarta dhe të kuptueshme.

Rregullat duhet të qartësojnë afatet e shqyrtimit të aplikimit. Në çdo rast, ato të mos kalojnë afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti i aplikimit.

Autoritetet përgjegjëse, me qëllim lehtësimin e procesit, caktojnë pikën/at e kontaktit për të drejtën e kalimit, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, e cila duhet të jetë e publikuar.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 29, datë 25.2.2022

PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE, KUSHTEVE DHE MËNYRËS SË MBROJTJES SË VEÇANTË PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE DHE DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 20, pika 3, të ligjit nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”,

UDHËZOJNË:

1. Përcaktimin e rasteve, kushteve dhe mënyrën e mbrojtjes së veçantë për punonjësit e Policisë së Burgjeve, drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (këtu e në vijim, “Institucioneve”) dhe familjen apo pronën e tyre, për shkak të detyrës që mbajnë apo që kanë kryer.

2. Punonjësit të Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit të Institucionit i sigurohet mbrojtje e veçantë personale, e familjes dhe e pronës, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, kur, gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj, i rrezikohet jeta, shëndeti i tij dhe/ose i familjes ose prona. Mbrojtje e veçantë i sigurohet edhe punonjësit që nuk e ushtron më detyrën, në rast se e kërkon, në rast cenimi për shkak të ushtrimit të mëparshëm të detyrës.

3. Me mbrojtje të veçantë personale, të familjes dhe të pronës, sipas këtij udhëzimi, do të kuptohen masat me karakter organizativ e profesional, për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes e të pronës së punonjësit të Policisë së Burgjeve dhe drejtuesit të Institucionit, si dhe masat e tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

4. Kushtet për të përfutur mbrojtje të veçantë janë, si më poshtë vijon:

a) ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, i bazuar në prova për rrethana serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pasurinë;

b) prania e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave serioze dhe ushtrimit të detyrës ose ushtrimit të mëparshëm të detyrës.

5. Pavarësisht mungesës së lidhjes shkakësore të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 4, të këtij udhëzimi, punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit i sigurohet mbrojtje e veçantë edhe në rast të pranisë së rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

6. Kërkesa për mbrojtje të veçantë i paraqitet komisionit përkatës me shkrim nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, ministri i Drejtësisë, drejtuesi i përgjithshëm i Burgjeve, drejtuesi i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, drejtuesi i Institucionit ku punonjësi ushtron detyrën, si dhe çdo organ tjetër publik që, për shkak të funksionit, merr dënim për praninë e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën e tij.



7. Kërkesa për mbrojtje të veçantë përmban:

- a) gjeneralitetet e plota të kërkesës;
- b) një përmbledhje të fakteve e të rrethanave, që përbëjnë rrezik serioz për punonjësin, të cilat detyrojnë të sigurohet mbrojtje e veçantë;
- c) burimin e provave, ku bazohen ato;
- ç) llojin e masave që kërkohen dhe kohëzgjatjen e tyre.

8. Kërkesa për mbrojtje i paraqitet komisionit, sipas rastit, nga subjektet e përcaktuara në pikën 6, të këtij udhëzimi, kur ka të dhëna të besueshme që provojnë se punonjësit së Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit i rrezikohet jeta, familja ose prona.

9. Kur rreziku është serioz dhe i çastit, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron strukturat e Policisë së Shtetit të marrin masa paraprake të menjëhershme për të garantuar jetën, familjen ose pronën e punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit, deri në mbledhjen e komisionit. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerëson masat e marra nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe vendos, kur është rasti, për vazhdimin e mëtejshëm të tyre.

10. Kërkesat për sigurimin e mbrojtjes së veçantë shqyrtohen, sipas rastit, nga Komisioni për Mbrojtjen e Veçantë (në vijim “Komisioni”), i cili ngrihet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë, me përbërje si më poshtë vijon:

- a) 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, i caktuar nga ministri, i cili është njëkohësisht edhe kryetar i komisionit;
- b) 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, i caktuar nga ministri;
- c) 1 (një) përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i caktuar nga drejtuesi i përgjithshëm i Burgjeve;
- ç) 1 (një) përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i caktuar nga drejtuesi i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

11. Anëtarët e Komisionit kanë mandat 2-vjeçar (dyvjeçar).

12. Institucionet e përcaktuara në pikën 10 të këtij udhëzimi, caktojnë edhe nga 1 (një) përfaqësues zëvendësues, për të garantuar funksionimin e Komisionit në situata të veçanta.

13. Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi

e këtij udhëzimi caktojnë përfaqësuesit e Komisionit.

14. Kryetari i Komisionit ushtron këto funksione:

- a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit;
- b) përfaqëson Komisionin në marrëdhëniet me të tretët;
- c) siguron mbështetjen administrative dhe organizative për funksionimin e Komisionit;
- ç) siguron dokumentimin e mbledhjes së Komisionit dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat.

15. Kryetari, menjëherë pas marrjes së kërkesës për mbrojtje, njofton anëtarët e Komisionit për mbajtjen e mbledhjes. Komisioni duhet të mbledhet menjëherë dhe jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga paraqitja e kërkesës.

16. Ministria e Drejtësisë siguron mbështetjen e nevojshme organizative e administrative për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Komisionit.

17. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme, kur në të janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij. Vendimet janë të vlefshme kur miratohen të paktën nga 3 (tre) anëtarë të pranishëm në mbledhje.

18. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë udhëzim, si dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për organizimin e funksionimin e organeve kolegjiale.

19. Pjesëmarrja në mbledhjet e Komisionit është e detyrueshme. Kryetari i komisionit, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, cakton një sekretar, nga radhët e nëpunësve të Ministrisë, i cili mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes.

20. Komisioni, në procesin e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje të veçantë të familjes e të pronës, sipas këtij udhëzimi, mund të kërkojë informacione nga institucione të tjera.

21. Komisioni merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur dhe, kur bindet për nevojën e sigurimit të mbrojtjes, shprehet me vendim për të.

22. Vendimi përmban masat konkrete të mbrojtjes së veçantë, numrin e shoqëruesve personalë, kur është rasti, afatin, brenda të cilit sigurohet mbrojtja, si dhe masa të tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.



23. Vendimi i Komisionit i njoftohet punonjësit së Policisë së Burgjeve nëpërmjet drejtuesit të Institucionit ku ushtron detyrën. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit njofton strukturat përgjegjëse për mbrojtjen. Punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit, që nuk e ushtron më detyrën ose që ka dalë në pension, i njoftohet vendimi i Komisionit pranë vendbanimit ose vendqëndrimit të tij.

24. Komisioni, me kërkesë të subjekteve të përcaktuara në pikën 6 të këtij udhëzimi, kur ka të dhëna të besueshme që provojnë se një punonjësi të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit i rrezikohet jeta, familja ose prona, mund të vendosë zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, nëse rrethanat, për të cilat është siguruar më parë mbrojtja, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të afatit fillestar.

25. Në rast se rreziku ndaj jetës, familjes ose pronës pushon së ekzistuari përpara përfundimit të afatit të mbrojtjes, sipas përcaktimit në vendimin e Komisionit, me kërkesën e çdo subjekti të përcaktuar në pikën 6 të këtij udhëzimi, Komisioni mund të vendosë të ndërpresë mbrojtjen e veçantë.

26. Në rast se punonjësit të Policisë së Burgjeve apo drejtuesit të Institucionit i shkaktohen dëme për jetën, shëndetin, pronën e tij ose familjes së tij, gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, dëmet shpërblehen nga shteti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

27. Ngarkohen Komisioni, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

28. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

UDHËZIM

Nr. 33, datë 11.3.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 927, DATË 1.11.2021, “PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATAVE TË PASURISË DHE INTERESAVE PRIVATË NË FORMË ELEKTRONIKE, NË SISTEMIN ELEKTRONIK PËR DEKLARIMIN E PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT (EACIDS)”

Në mbështetje të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 22.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit EACIDS’”, si dhe shkresave nr. 1021/1 prot., datë 9.3.2021 dhe nr. 1021/2 prot., datë 9.3.2021, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

UDHËZON:

Pika 8, germa “a”, ndryshon si më poshtë vijon:

“8. Subjektet deklaruese duhet të plotësojnë deklaratat e interesave privatë përkatëse, sipas mënyrës dhe afateve të mëposhtme:

a) Subjektet të cilët mbartin detyrimin ligjor të bëjnë deklarimin periodik vjetor të interesave privatë dhe konfliktit të interesave, për vitin 2021, duhet të plotësojnë deklaratën e interesave privatë periodike vjetore, në formë elektronike për subjektet në funksion, për pasuritë e akumuluar ndërmjet vite dhe detyrimet financiare, me gjendje më 31.12.2021, si dhe burimin e krijimit të tyre. Deklarata e interesave privatë periodike vjetore, në formë elektronike, për subjektet në funksion, duhet plotësuar dhe dorëzuar brenda datës 31 tetor 2022, si vijon:

- në formë elektronike, duke kryer plotësimin dhe aprovimin e versionit përfundimtar të deklaratës në sistemin EACIDS, të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, dhe;



- në formë shkresore, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, deklarata e plotësuar në formë elektronike duhet printuar e nënshkruar në çdo fletë të saj, sipas rubrikave përkatëse dhe dorëzohet e mbyllur në zarf, pranë autoritetit përgjegjës të institucionit publik.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Evgjeni Bashari

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 592 lekë